




CUP – KOMPETENCA NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS



Tempus

“CUP – KOMPETENCA NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS” PËRMBLEDHJE STUDIMESH



Përmbledhje

Me këtë broshurë, e cila është përmbledhje studimesh të mësimdhënies së bazuar në kompetenca, ne kemi për qëllim të ofrojmë një vështrim mbi këtë lëmi komplekse. Kompetencat janë shtyllë e mësimdhënies moderne në institucionet e arsimit të lartë. Ato paraqesin bazë për zhvillimin e kurikulave dhe plan-programeve mësimore, përdoren për të definuar aktivitetet mësimore dhe respektivisht duhet të vlerësohen. Në shumë shtojca të diplomës jepen shtesë mbi të diplomuarit në formë të vlerësimit të kompetencave. Kjo broshurë përmbledh studimet mbi përdorimin e kompetencave në mësimdhënie dhe hulumtim në institucionet e arsimit të lartë. Ajo do të prezantojë rrethanat, problemet, zgjidhjet dhe strategjitë e ndryshme me qëllim të lejojë qasjen në këtë lëmi nga këndet e ndryshme. Siç është shpesh rasti me lëmitë e reja, qasjet dhe qëllimet e mbuluara në këta artikuj mund të ndryshojnë dhe në disa raste edhe të kundërshtojnë njëri tjetrin. Kjo broshurë nuk ka për qëllim të vlerësojë apo të rangojë përvojat e grumbulluara sipas cilësisë apo efektit por, ofron një pasqyrë të përvojës dhe mënyrës së trajtimit të mësimdhënies së bazuar në kompetenca në institucionet e arsimit të lartë në Evropë.

Ky publikim është pjesë e rezultateve të projektit Kompetencat në Universitetin e Prishtinës (Competence @ University of Prishtina (CUP)), i cili bashkë-financohet nga programi TEMPUS i Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Përshkrimi i Projektit “CUP – Kompetenca në Universitetin e Prishtinës”	4
1. Hyrje.....	4
2. Informacion mbi partnerët	6
3. Detajet kontaktuese	8
Prezantimi i arsimimit të bazuar në kompetencë	9
1. Fusha e arsimit të lartë europian dhe fokusi i saj në rezultatet e të nxënit	9
2. Përcaktimi i kompetencave	9
3. Marrëdhënia mes qëllimeve, kompetencave, përmbajtjes së lëndës dhe aktiviteteve të mësimnxënies	10
4. Vlerësimi i kompetencave	10
5. Rëndësia e vlerësimit të kompetencave për tregun e punes dhe për aktorët universitarë	11
6. Vlerësimi i kompetencave	12
7. Katalogu i kompetencave - Çka paraqet ai?	14
8. Katalogu i kompetencave – Pse është i rëndësishëm?	15
9. Katalogu i kompetencave – Çfarë përmban ai?	15
10. Nga kompetencat deri te aktivitetet e mësimnxënies.....	16
Strategjia mësimnxënies së bazuar në kompetencë në nivel universiteti dhe fakulteti	19
1. Hyrje.....	19
2. Përcaktimi i kompetencave	19
3. Implementimi i mësimnxënies me bazë në kompetenca në Universitetin e Alicante.....	24
4. Përfundim	27
Katalogjet e kompetencave dhe përdorimi i tyre praktik.....	28
1. Koncepti i kompetencës – si përcaktohet dhe cila është vlera që e paraqet për krijimin e lidhjeve me shoqërinë	28
2. Marrëdhënia mes kompetences dhe rezultateve të të nxënit si dhe me kornizën e kualifikimeve.....	30
3. Mësimnxënia e bazuar në kompetencë përballë mësimnxënies së bazuar në përmbajtje	30
4. Kompetencat e përgjithshme dhe të veçanta	31
5. Si të përpilohet katalogu i kompetencave	33
6. Nga lista e kompetencave deri në klasë	34
7. Arritja dhe shprehja e rezultateve të të nxënit	36

Zhvillimi i kompetencave me detyra jo rutinore: harmonizimi i shkathtësive me nevojat e tregut të punës në dritën e mundësive të teknologjive të reja	37
1. Abstrakt	37
2. Hyrje.....	37
3. Projekti: “Në kontakt me tregun e punës”	38
4. Mësimnxënia e bazuar në Kompetencë	39
5. Të promovohet adoptimi i paradigmës së mësimnxënies me bazë në kompetencë: mundësitë e teknologjive të reja	40
6. Përmbledhje	41
Sistemi i kompetencës i bazuar në ECTS	42
1. Hyrje	42
2. Planifiko, bëj, kontrollo, vepro	42
Praktika e mirë e zhvillimit të kurikulës në Universitetin e Prishtinës (UP), Kosovë.....	49
1. Hyrje.....	49
2. Paraqitja e sfondit	49
3. Proceset e zhvillimit të programit të mësimi.....	50
4. Përfundim.....	52
5. Rekomandimet.....	53

Përshkrimi i Projektit “CUP – Kompetenca në Universitetin e Prishtinës”

Rupert Beinhauer, FH JOANNEUM, Universiteti i Shkencave Aplikative, Graz

1. Hyrje

Projekti CUP e adreson lidhjen e munguar në mes arsimit të lartë (AL) dhe ekonomisë në hapësirën e Kosovës.

Duke u bazuar në procedurat e sigurimit të cilësisë të “Kornizës Europiane të Kualifikimeve” projekti CUP synon të zhvillojë dhe avancojë procedurat dhe instrumentet për vlerësimin dhe përmirësimin e harmonizimit të kompetencave që zhvillohen në institucionet e arsimit të lartë me ato që kërkohen nga tregun i punës. Metodologjia që do të ndërtohet në kuadër të këtij projekti do të ketë për bazë bartjen e njohurive nga universitetet partnere nga BE dhe pastaj do t’i përshtatet nevojave lokale.

Për të mundur bartjen e kompetencave të nevojshme në arsimin e lartë duhet themeluar “Qendra për Observim dhe Kompetencë” (QOK). Kjo qendër do të jetë bazë e bartjes së dijes kombëtare, bazë e trajnimeve të institucioneve të arsimit të lartë dhe të aktorëve të tjerë të rëndësishëm, po gjithashtu do të shërbejë edhe për nevojat e Universitetit të Prishtinës. Kjo qendër gjithashtu do të observojë dhe monitorojë zhvillimet kombëtare dhe ato europiane në fushat respektive.

Vlerësuar nga perspektiva europiane, CUP synon të afrojë sistemin e arsimit të lartë të Kosovës edhe një hap më afër “Kornizës së kualifikimit europian” (nga ang. EQF, European Qualifications Framework), po ashtu edhe me zonën e arsimit të lartë europian (European Higher Education Area (EHEA) duke e pajisur me instrumentet që garantojnë cilësinë “nga jashtë” duke e lidhur botën e arsimit me atë të punësimit.

CUP përbëhet nga **9 module** të cilat janë përshkruar shkurtimisht më poshtë:

1. Zhvillimi dhe avancimi i metodologjisë së aplikuar për vlerësimin dhe harmonizimin e kompetencave të zhvilluara në universitet me ato që i kërkon tregun i punës.
2. Themelimi i një qendre që do të quhet: “Qendra për Kompetencë dhe Observim” (QKO). Qendra do të krijohet në vitin e parë të kohzgjatjes së projektit dhe do të jetë në funksion gjatë gjithë fazave të tjera të këtij projekti. Kjo gjë shihet si një masë praktike për ngritjen e kapaciteteve të personelit vetanak. Detyrë e personelit është të zhvillojë dhe të mirëmbajë web platformën KOMPETENCAT për hartimin e katalogjeve të kompetencave dhe të funksionalizojë qendrën që të ofrojë shërbime për të gjithë aktorët relevantë.
3. Realizimi i dy studimeve pilot, në fazën e parë të projektit, që kanë të bëjnë me kualifikimet e fituara në universitet dhe të atyre që nevojiten për tregun e punës duke përdorur metodologjinë e zhvilluar. Me këtë hap bëhet i mundur testimi i metodologjisë dhe instrumentëve të zhvilluar. Testimi do të bëhet me mbështetjen e personelit të QKO dhe të ekspertëve nga BE. Në këtë mënyrë personeli i QKO do të fitojë përvojë

praktike ashtu që edhe më tej të mund të konsultojë dhe monitorojë të tjera procese të së njejtë rëndësi. Rezultatet e studimeve do të shërbejnë si shembull konkret për përdorimin e metodologjisë dhe instrumenteve të krijuara.

4. Hartimi i “Katalogut të kompetencave” – Ky katalog i kompetencave do të bazohet mbi aktivitetet e më hershme të projektit dhe mbi shembujt e mirë nga përvoja e Geronës, Gentit dhe Gracit (partnerë nga BE). Ky katalog i kompetencave do të hartohet dhe botohet në platformën e rrjetit të internetit me qëllim të shpërndarjes së drejtë të rezultateve të projektit.
5. Ndërtimi i një sistemi informativ – ky system informativ do të bazohet në përvojën e partnerëve të BE-së dhe në hartimin e katalogut të kompetencave që u përmend më lart. Një sistem i tillë informativ që përbëhet nga një server informativ dhe nga së paku 32 terminale (mesatarisht dy për një fakultet) që do të vendoset në mënyrë strategjike nëpër gjithë kampusin e Universitetit të Prishtinës. Këto terminale do t’u mundësojnë studentëve, po edhe personelit, të përdorin sistemin informativ për të kontrolluar oraret, kurrikulën dhe syllabuset e lëndëve të tyre. Përdoruesit do të kenë qasje në katalogun e kompetencave dhe do të mund të shohin se në çfarë mënyre lidhen kompetencat me kurset e tyre. Ky sistem do të prezantohet në gjithë universitetin dhe do të jetë edhe një nxitje më shumë drejt përdorimit të qasjes së bazuar mbi kompetencat.
6. Shpërndarja e dijes dhe përvojës në mesin e aktorëve nga universiteti, biznesi dhe politika. Instrumentë kryesor të shpërndarjes së qëndrueshme të rezultateve të projektit do të jenë terminalet informative të CUP, web faqet e CUP, manualët, pyetësorët, rekomandimet për hartimin e strategjive etj. Shpërndarja e mëtejme është menduar të bëhet përmes: trajnimeve të shumëfishuara, takimeve informative, uorkshopeve, konsultimeve etj.
7. Sigurimi i qëndrueshmërisë së rezultateve të projektit. – projekti është hartuar ashtu që të përmbush kriteret e qëndrueshmërisë ndërsa hartimi i strategjisë përkatëse mund të përmblihet si në vijim: Themelimi i “Qendrës për Observim e Kompetencë” do të shërbejë si qendër e njohurive dhe shërbimi për Universitetin e Prishtinës. Ajo do të vendoset afër zyrës për sigurimin e cilësisë, në hapësirat që do t’i ofrojë Universiteti i Prishtinës. Personeli i QOK do të trajnohet dhe pasi projekti të ketë përfunduar shpenzimet e personelit do të jenë përgjegjësi vendore. “Produktet” e projektit si, manualët, udhëzuesit mbi kurrikulën dhe ndërtimin e strategjisë, katalogjet e kompetencave, rezultatet e studimeve etj do t’u shpërndahehen të gjithë aktorëve relevantë si, do të postohen në web platformën e CUP si dhe në terminalet informative, në mënyrë që të jenë në disponim të të gjithë aktorëve relevantë.
8. Përmbushja e procedurave të kontrollit të cilësisë – cilësia është një nga objektivat kryesore të këtij projekti. Implementimi i projektit do të përcillet me monitorim dhe kontroll përkatës (si përmbajtësor ashtu edhe financiar)
9. Përmbushja e menaxhimit të projektit duke përdorur instrumentet dhe procedurat më të azhornuara të menaxhimit të projekteve. Përvoja e pasur e partnerëve të projektit veçanërisht ajo e koordinatorit do të mundësojë përmbushjen e një menaxhimi të drejtë e të detajuar të projektit.

Të gjitha këto module kontribuojnë drejt realizimit dhe e ndihmojnë suksesin pozitiv të projektit.

2. Informacion mbi partnerët

FH JOANNEUM është një ndër Universitetet lider, të Shkencave të Aplikuara, të Austrisë. Universiteti ofron programe kualifikimi të niveleve të ndryshme që për synim kanë trajnimin profesional mbi bazë shkencore. Qendrat për Zhvillim dhe Kërkim shërbejnë si hallka të rëndësishme lidhëse mes departamentëve të ndryshme të FH JOANNEUM dhe të botës së biznesit, duke siguruar që trajnimi i studentët të jetë i orientuar nga praktika dhe të bëhet me metodologjinë më të avancuar. FH JOANNEUM ka përmbushur me sukses një numër të madh hulumtimesh dhe projektesh zhvillimore për institucione dhe kompani të ndryshme.

WUS Austria është organizatë joqeveritare, politikisht e pavarur, e përkushtuar për liri akademike dhe për të drejta në arsim. WUS Austria ka përmbushur një numër të madh projektesh në Europën juglindore, që kanë synuar përkrahjen direkte të reformës dhe zhvillimit të arsimit të lartë sipas standardeve ndërkombëtare dhe europiane. Krahas partneritetit të fortë insitucional me univesitetet e Europës juglindore, WUS Austria gjithashtu ka ndërtuar një rrjet të madh tematik me partnerë nga BE. Duke facilituar bashkëpunimin dhe transferin e dijes mes universiteteve të BE dhe atyre të Europes juglindore, WUS Austria është pozicionuar si një nga parnerët më të rëndësishëm operative që për shooqërinë e dijes së Europës juglindore, ofron përkrahje (teknike, financiare) dhe konsultime për implementimin më të shpejtë dhe më efikas të reformës së BE.

Fondacioni i përgjithshëm i Universitetit të Alicante (The General Foundation of the University of Alicante (UAFG) u krijuar në vitin 2000 nga ana e Universitetit të Alicante (UA) me qëllim të promovimit efikas të rolit qendror të universitetit si gur themel i zhvillimit ekonomik shoqëror i shoqërive që bazohen në dije. Objektiva e UAFG është të mbështesë Universitetin e Alicante në fushën e transferit të dijes, të hulumtimit dhe të trainimit profesional. UAFG mund të konsiderohet si faqja e parë e Universitetit të Alicante me biznesin.

KaHoSin-Liven (Catholic University College Ghent) është kolexh universitar në Flandri që ka më tepër se 6300 studentë dhe mbi 600 anëtarë personeli. KaHoSint-Lieven ofron programe të nivelit Bachelor dhe Master në Ghent, Aalst dhe Sint-Niklaas. Këto programe studimore përfshijnë këto fusha: bioteknologji, kujdes shëndetësor, studime biznesi, shkollim të mësuesv, shkenca industrial dhe teknologji. KaHoSint-Lieven ka përvojë të madhe në mësimin e bazuar në kompetenca. Që të gjitha kurrikulet i kanë të përcaktuara shumë qartë rezultatet e të nxënit dhe të gjitha ato janë hartuar në mënyrë mjaft fleksibile.

Universiteti i Gironës është institucion publik, i përkushtuar për ekselencë në mësimdhënie dhe hulumtim por i përkushtuar edhe për pjesmarrje në progres dhe zhvillim të shoqërisë përmes krijimit, transmetimit, shpërndarjes dhe kritikizmit të dijes të lidhur me shkencën, teknologjinë, shkencat humanitare, shkencat shoqërore dhe me artet. Universiteti i Gironës, ka rrënjë të thella në Kataloni dhe në kulturën katalone, është një ndër promotorët kryesorë të ekonomisë dhe kulturës së regjionit.

C.A.T.T.I.D. (Centre of Applications for Television and Digital Technology Innovation) e “La Sapienza” , (Qendra Aplikative e Televizionit dhe Teknologjisë Digjitate Inovative) Universitetit të Romës, është aktive që nga viti 1988, është një lloj ndër-departamenti, ndër-universiteti dhe funksionon në bashkëpunim me disa nga ndërmarrjet më të rëndësishme të sektorëve që janë më së shumti të involvuar në proceset e hulumtimit dhe konvergencës digjitale.

Universiteti i Prishtinës është relativisht i ri në krahasim me traditat universitare të vendeve të ndryshme në botë. Roli i Universitetit të Prishtinës që nga themelimi i tij ishte po ai rol që është tipik edhe për universitetet në vendet e civilizimit perëndimor, iluminist dhe liberator nga tutela e të tjerëve. Universiteti i Prishtinës është njëri ndër insitucionet e para të arsimit të lartë të regjionit që ka nisur procesin e reformave të thella, në harmoni me procesine Bolonjës.

Agjencioni Kosovar i Akreditimit (AKA) është themeluar nga MASHT-i në pajtim me ligjin e Kosovës për arsimin e lartë, si një agjencion që ushtron aktivitete profesionale jo-profitabile që sigurojnë cilësinë e punës arsimore dhe hulumtuese. AKA është agjencion publik për vlerësimin e cilësisë së institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë që përmes procesit të akreditimit mbështet zhvillimin e cilesisë te këto institucione. AKA ka gjithë bazën e duhur ligjore për akreditimin e të gjitha institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë apo që duan të ofrojnë programe të arsimit të lartë që mundëson kualifikimin universitar.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Planifikimi dhe observimi i zhvillimit të sistemit të arsimit të lartë është përgjegjësia kryesore e MASHTit. Për këtë arsye MASHT zhvillon plane dhe dokumenton politikat, standardet si dhe procedurat që sjellin zgjedhje sistematike për sfidat me të cilat ballafaqohet arsimit i lartë në Kosovë.

3. Detajet kontaktuese

AUSTRI

Mag. Rupert Beinhauer
Fachhochschule Joanneum Graz
Fakulteti i Menaxhmentit Ndërkombëtar
Eggenberger Allee 11
8020 Graz
Austria
Phone: +43 316 5453 6822
E-mail: rupert.beinhauer@fh-joaanneum.at

KOSOVA

Milote Sadiku
University of Prishtina
Fakulteti ekonomik, Rr. Agim Ramadani
10 000 Prishtinë
Kosova
Tel: +381 38 244 183 /244 186
Fax: +381 38 244 187
E-mail: milote.sadiku@uni-pr.edu

Prezantimi i arsimimit të bazuar në kompetencë

Rupert Beinhauer, FH JOANNEUM, Universiteti i Shkencave Aplikative, Graz

Teksti në vazhdim është hartuar nga autorë të ndryshëm në kuadër të projektit të TEMPUS “KOMPETENCA” dhe është botuar në katër “Manuale të Kompetencës”. Këto botime janë përmbledhur dhe ribotuar këtu për lehtësinë tuaj. Kopjet origjinale të këtyre manualeve mund të shkarkohen nga web faqja “KOMPETENCA”.

1. Fusha e arsimit të lartë europian dhe fokusi i saj në rezultatet e të nxënit Rupert Beinhauer, FH JOANNEUM, Universiteti i Shkencave Aplikative, Graz

Rezultate e të nxënit tani janë temë e nxehtë në mesin e institucioneve arsimore të Europës, ato tani po analizohen, diskutohen, implementohen dhe vlerësohen nëpër gjithë Europën. Bazuar në idetë relevante si dhe nga inspirimi i zhvillimeve europiane të sektorit arsimor, nga një anë Korniza e Kualifikimit Europian (EQF, European Qualifications Framework) dhe nga ana tjetër Korniza e Kualifikimeve për Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë, (Qualifications Framework for the European Higher Education Area (QF-EHEA)) rezultate e të nxënit janë shtylla kryesore e iniciativës arsimore. Metodrat dhe modelet tradicionale të shprehjes së suksesit dhe niveleve të kualifikimit janë zëvendësuar nga sisteme që bazohen në përshkrime të kualifikimit dhe të rezultateve të të nxënit. Këto sisteme, në mënyrë direkte e paraqesin transparencën e duhur për të lehtësuar krahasueshmërinë e dijes, aftësive dhe zotësive në mes insitucioneve arsimore të vendeve të ndryshme europiane. “Pa këto qasje të përbashkëta, do të ishte e vështirë arritja e njohjes së plotë, transparenca reale dhe kësisoji edhe krijimi efektiv i një Hapësire të Arsimit të Lartë Europian.” (Grupi i punës për kornizën e kualifikimeve, Bolonjë dhjetor 2004)

2. Përcaktimi i kompetencave

Bernadette Frech, FH JOANNEUM, Universiteti i Shkencave Aplikative, Graz

Në dekadën e fundit është shtuar interesimi për arsimin e bazuar në kompetenca (Gillies& Howard, 2003; Gordon & Issenberg, 2003; James, 2002). Akordimi i strukturave arsimore në Europë, një projekt i udhëhequr nga universiteti që synon të ofrojë një qasje konkrete për implementimin e procesit të Bolonjës në nivel të institucioneve të arsimit të lartë dhe të fushës së studimit, kompetencat i përcakton si kombinim dinamik i njohurive, i të kuptuarit, i shkathtësisë dhe i aftësisë. Studentë i përvetësojnë apo i arrijnë kompetencat gjatë procesit të mësimnxënies (Tuning 2007). Mund të dallojmë dy lloje kompetencash: kompetenca të përgjithshme (dmth kompetenca të transferueshme përgjatë fushave të studimit) dhe kompetenca të veçanta sipas fushës (dmth kompetenca specifike vetëm për një fushë të caktuar).

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve për Instrukcionet e Trajnimit dhe të Performancës (International Board of Standards for Training and Performance Instruction, IBSTPI) kompetencën e përcakton si “njohuri, shkathtësi, apo qëndrim që i mundësojnë njeriut të performojë në mënyrë efektive veprimet e një profesioni të caktuar apo të funksionojë sipas standardeve të kërkuara të punësimit” (IBSTPI, 2005).

Kombinimi i përcaktimeve të Tuning dhe IBSTIP tregon se kompetenca i përfshin mjetet po edhe rezultatit. Mjetet janë kombinimi i njohurive, shkathtësive, apo aftësive ndërsa rezultati është performanca efektive e veprimeve të një profesioni të caktuar apo funksionimi sipas standardeve të pritura të punësimit. Është me rëndësi thelbësore që hartimi i kurikulës së bazuar në kompetenca të bëhet në atë mënyrë që të sigurojë se nxënësit do të jenë në gjendje të demonstrojnë kompetencat që i kanë përvetësuar pasi të kenë mësuar kombinimin e nevojshëm të dijes, shkathtësive dhe zotësive (Chyung 2006).

3. Marrëdhënia mes qëllimeve, kompetencave, përmbajtjes së lëndës dhe aktiviteteve të mësimnxënies

Josep Juandó i Bosch, Magüi Pérez Cabaní, Universiteti i Gironës, Girona, Spain

Sipas standardeve arsimore të përcaktuara në hapësirën e arsimit të lartë europian është propozuar që objektive e universiteteve të jetë përvetësimi i kompetencave nga ana e studentëve dhe që këto kompetenca të fituara të jenë të përshtatura me studimet që ata i përmbushin. Studentët i përvetësojnë këto kompetenca përmes aktiviteteve të mësimnxënies.

Këto aktivitete duhet të lidhen me përmbajtjet e studimeve përkatëse. Me një fjalë, referencë e mësimnxënies janë kompetencat që duhet përvetësuar, instrumentet janë aktivitetet e mësimnxënies gjatë periudhës së studimeve. Këto aktivitete funksionojnë në përmbajtjet të cilat paraqesin materialin apo lëndën bazë të mësimnxënies. Figura më poshtë e ilustron këtë marrëdhënie.

Kësisoj, çelësi i gjithë sistemit është një definicion i qartë dhe i zbatueshëm i kompetencave dhe një lidhje efektive e tyre me aktivitetet e mësimnxënies.

4. Vlerësimi i kompetencave

Bernadette Frech, FH JOANNEUM, Universiteti i Shkencave Aplikative, Graz

Elementi crucial i modeleve me bazë në kompetencë është përdorimi i metodave të vlerësimit që i referohen kritereve të matshme (Chyung et al 2006). E thënë ndryshe, nëse flasim për një gjë që nuk mund të matet atëherë ajo me gjasë nuk është kompetencë fare. Kompetencat formohen nëpër njësi të ndryshme të kurseve, përmes aktiviteteve të ndryshme të mësimnxënies dhe vlerësohen në stadi të ndryshme.

Dallojmë vlerësimet e kompetencave sipas qasjes direkte apo indirekte (Prince & Randall 2008). Qasjet indirekte mbledhin opinione për cilësinë dhe sasinë e kompetencave të fituara, p.sh. nga grupet e fokusit apo nga studimet. Me sa duket vlerësimi i kompetencave mbështetet mbi një numër të caktuar mendimesh dhe refleksionesh të të anketuarve (Andrews & Higson 2007). E kundërta e kësaj, qasjet direkte kërkojnë që studentët të demonstrojnë përvetësimin e kompetencave duke vlerësuar punë të caktuara që i kanë bërë studentët. Mënyrë ideale e vlerësimit të tillë do të ishte kombinimi i performancës dhe funksionit formues dhe përmbledhës (Tuning 2007). Vlerësimet e performancës e analizojnë punën e studentëve me anë të testeve, provimeve me gojë, prezantimeve, raporteve nga labororet, analizave të teksteve dhe të portofolios. Vlerësimet formative të asaj forme që jep feedback zënë vend qendror te metoda e vlerësimit direkt. Kështu, ligjëruesit e

komentojnë punën e studentëve duke treguar se në çfarë mase e kanë arritur ata punën e caktuar deri në atë moment si dhe i identifikojnë hapat e mundshëm për përmirësim. Organizimi i një seminari apo ushtrimeve pas një provimi janë një shembull tjetër i vlerësimit formativ. Përveç kësaj secili kurs duhet të përmbajë një vlerësim përmbledhës që mundëson të mbledhen të gjitha pjesët e vlerësimit dhe të paraqiten me një notë.

5. Rëndësia e vlerësimit të kompetencave për tregun e punës dhe për aktorët universitarë

Bernadette Frech, Biviana Deisy Castro Buitrago, Rupert Beinbauer,
FH JOANNEUM, Universiteti i Shkencave Aplikative, Graz

Vite më parë vlerësimi i kompetencave nuk luante ndonjë rol të rëndësishëm për asnjë sistem arsimor të botës. Tani kjo pamje ka ndryshuar si përgjegje ndaj një tregu të punës i cili duke qenë vet i përqendruar në kompetenca edhe nga sistemi arsimor kërkon të bëjë zhvendosjen drejt një mësimnxënie mbi bazën e kompetencave (Vervenn & Xheneumont, 2005). Për të diplomuarit e rinj nuk mjafton vetëm baza e dijes teorike që ata e marrin por kanë nevojë edhe të përvetësojnë një sërë kompetencash që u mundësojnë atyre që të jenë më të shkathtë për t'u ballafaquar me sfida të reja dhe të panjohura. Në këtë kontekst brengat e aktorëve universitarë (Institucionet e arsimit të lartë, mësimdhënës dhe studentët) lidhur me efektivitetin e programeve studimore janë shtuar në mënyrë dramatike. Ewell dhe Boyer (1988) dhe Davis (1989) kanë theksuar se vlerësimi është i rëndësishëm për arsimin e lartë meqë siguron feedback që për institucionet ka rëndësi kruciale sepse u ndihmon atyre për t'u përmirësuar në mënyrë që të mund të përgatisin sa më mirë një student, një program apo një department. Prandaj, universitetet i shqyrtojnë boshllëqet mes kompetencave sipas mësimdhënies dhe sipas kërkesave të tregut të punës për të gjetur nëse janë larg apo afër mbylljes së këtyre boshllëqeve, dhe për të gjetur mënyrat si të ndryshohet kurrikula me qëllim të ngritjes së cilësisë, performancës dhe përgjegjësive të arsimit që e ofrojnë. Përmëtepër, duke i vlerësuar kompetencat studentët do të mund të marrin një arsim më transparent dhe në të nejtën kohë do t'i përvetësojnë shkathtësitë e nevojshme dhe kështu do të shtojnë mundësitë e punësimit të tyre, në të ardhmen. Personeli i universitetit do të ndikohen nga vlerësimet e tilla, gjithashtu meqë çdo ndryshim i kurikulës do të ketë ndikim në performancën përbrenda universitetit të procedurave administrative, materialeve dhe teknikave të mësimdhënies apo të përzgjedhjes së personelit.

6. Vlerësimi i kompetencave


Bernadette Frech, Biviana Deisy Castro Buitrago, Rupert Beinhauer,
Rene Wenzel, FH JOANNEUM, Universiteti i Shkencave Aplikative, Graz

Hager, Gonczi dhe Athanasou (1994) shpjegojnë se vlerësimi i bazuar në kompetenca është një proces që përcakton nëse një kandidat i zotëron apo jo aftësitë e nevojshme sipas kërkesave të punëdhënësve, me një fjalë nëse studentët arrijnë të demonstrojnë zotërimin e kompetencave apo jo. Thrash (1990) argumenton se vlerësimi “duhet të konsiderohet si mjet që mund të dokumentojë nëse institucionet vërtetë e bëjnë atë që thonë se janë duke e bërë dhe nëse studentët të cilët i përfundojnë studimet në programet e tyre arrijnë t’i marrin ato mësimet që u janë premtuar se do t’i marrin. Theksin duhet vënë mbi cilësinë institucionale dhe kompetencën individuale”. Në po këtë vijë argumentimi, Alderson dhe Wall (1993) e tregojnë rëndësinë e marrëdhënies në mes të mësimnxënies dhe të vlerësimit sipas asaj që quhet “efekti wash-back”, duke lënë për t’u kuptuar se ajo që vlerësohet ndikon shumë në atë që mësohet. E thënë ndryshe, nëse qëllimi i fundit i cilitdo vlerësim është matja e dijes faktike që është marrë në sistemin arsimor, atëherë studentët do të përgjigjen duke synuar t’i mësojnë vetëm faktet. Mirëpo, nëse universitetet përdorin ato mjete të vlerësimit që i përmirësojnë aftësitë e punsueshmërisë së studentëve të tyre ata do të kenë mundësi që në të ardhmen të tregojnë përshtatshmëri më të madhe ndaj kërkesave të tregut të punës. Projekti i TEMPUS KOMPETENCA e përforcon rëndësinë e vlerësimit adekuat dhe të saktë të kompetencave; ai synon “të zhvillojë dhe të avancojë procedurat dhe instrumentet e vlerësimit si dhe të përmirësojë harmonizimin mes kompetencave të zhvilluara nga institucionet e arsimit të lartë me ato që kërkohen nga tregu i punës, në katër vendet partnere të Ballkanit perëndimor”.

Metodologjia e kompetencës mbi të cilën bazohet KOMPETENCA është zhvilluar nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara FH Joanneum në kuadrin e projektit të tyre LLP (Leonardo da Vinci) MISLEM. Kjo metodologji përmban tetë hapa:

- 1. Përgatitja e grupit të fokusit:** Bëhen intervista me grupin e fokusit me qëllim të zbulimit të kompetencave specifike dhe të përgjithshme (5-6 anëtarë të grupit me një moderator është numri ideal, moderatorin duhet ta kthejë diskutimin tek çështjet e adresuara sa here që sheh se ai ka filluar të kalojë në shtigje tjera.
- 2. Analizimi i grupit të fokusit:** përdoren kompetenca të veçanta për të hartuar pyetësorët ndërsa kompetencat e përgjithshme akordohen me rezultatet e pyetësorit.
- 3. Hartimi i pyetësorëve:** Nevojiten dy pyetësor: njëri për të punësuarit dhe një tjetër për ish studentët. Objektivat kryesore që synon pyetësori janë:
 - Të hulumtojë perceptimin e të diplomuarve për cilësinë e përvojës së tyre arsimore
 - Të hulumtojë se sa është i kënaqur personeli me programin relevant të studimeve të paradiplomimit
 - Të identifikojë perspektivat e kualifikimit të të diplomuarve sipas dijes dhe aftësive në disiplinat kryesore të studimeve të tyre
 - Të identifikojë perspektivat e kualifikimit dhe shkallën deri në të cilën janë mësuar kompetencat e punsueshmërisë të studimeve të paradiplomimit
 - Të testojë se në çfarë mase janë përdorur kompetencat e punsueshmërisë të fituara në studime nga ana e të diplomuarve, gjatë punësimit të tyre.

4. **Ekzekutimi dhe analizimi i studimeve kuantitative:** Studimi duhet të bëhet në të gjitha universitete/vendet pjesmarrëse. Për secilin studim (të diplomuar dhe personeli) kërkohet të mbledhet sasia prej 100 pyetësorëve minimum. Pyetësorët për të diplomuarit bëjnë pyetje lidhur me shkallën e satisfaksionit të tyre me kompetencat që u janë mësuar atyre gjatë studimeve dhe sa janë të rëndësishme ato për punën e tyre aktuale. Në anën tjetër, pyetësori për personel vlerëson shkallën e satisfaksionit të tyre me kompetencat e përgjithshme dhe të veçanta të të diplomuarve dhe sa janë të përdorshme ato për punësim të ardhshëm.
5. **Krijimi i një matrice të kompetencave:** Krijohet një matricë e kurrikulës mbi bazën e rezultateve të studimit. Kjo matricë është një instrument për të siguruar që kompetencat të mësohen në kuadrin e kurseve të një programi, me të cilat përshtaten më së miri. Që të gjitha lëndët që mësohen me një program harmonizohen me kompetencat që studentët duhte t'i kenë në mbarim të studimeve të tyre. Lëndët e programit janë renditur në rreshta ndërsa kolonat paraqesin kompetencat korresponduese.
6. **Softueri i matricës së kompetencave:** Do të ketë mundësi të përdoret softueri i zhvilluar nga Universiteti i Gironës. Në këtë stad departamenti ka për detyrë që me ndihmën e softuerit t'i caktojë kompetencat përkatëse për secilën lëndë.
7. **Planifikimi i aktiviteteve dhe metodave të vlerësimit:** Matrica do të plotësohet duke i përkthyer kompetencat (e përgjithshme dhe të veçanta) në aktivitete dhe rezultate të të nxënit.
8. **Evaluimi:** Evaluimi i rezultateve të reja të mësimnxënies meqë ka rëndësi jetike të dihet cili është impakti i vlerësimit.



7. Katalogu i kompetencave - Çka paraqet ai?

Josep Juandó i Bosch, Magüi Pérez Cabaní, Universiteti i Gironës, Girona

Siç është thënë në manualët e mëparshme të këtij projekti, kompetencat janë pika kryesore e referimit në kuadër të modelit për menaxhimin e mësimdhënies që ka për qëllim të ndihmojë universitetet për t'iu përgjigjur nevojave të shoqërisë.

Siç është theksuar në manualin nr. 1 kompetencat shprehin nevojat e arsimit të lartë të një shoqërie ndërsa përdorimi i kompetencave shprehë nevojat për aftësi teknike.

Nga kjo pikëvështrimi, aftësia teknike bazohet në dije. Duke e vënë ketë dije në praktikë mund të arrijmë të kuptojmë situatën aktuale të arsimit dhe kështu mund të ndërmerim aktivitete të mëtutjeshme në pajtim me këto dije. Në esencë kur të diplomuarit nga universiteti veprojnë në kuadrin e fushës së tyre të dijes dhe e zbatojnë ndonjë kompetencë, atëherë dija e nxënë vihet në punë dhe përdoret. Gjithashtu, ka mundësi të shihet përmes performancës së tyre se në cilën masë ata vetë e dinë se ku ndodhen (konteksti) dhe gjithashtu nëse dinë se si të sillen në atë kontekst.


Kjo qasje, mes interpretimeve të ndryshme të dijes, të të kuptuarit, të aftësisë teknike, të dijes ku të jesh dhe si të jesh është mënyra më e lehtë për të vizualizuar aftësinë teknike, e cila vetvetiu tregon atë që një person di, si dhe tregon kualitetet që i ka një person. Për këtë shkak ekipi nga Girona ka zgjedhur interpretimin në vazhdim për konceptin “kompetenca”: aftësi teknike që mund të vizualizohet dhe të testohet.

Qasja pedagogjike sugjeron drejtimin kah përvetësimi i kompetencave, të cilat kuptohen si kërkesa për veprime komplekse dhe të kontekstualizuara që një shoqëri ua kërkon të diplomuarve universitar t'i kenë dhe të mund t'i zbatojnë.

Thënë shkurt, theksi duhet vënë mbi dy çështje fundamentale:

1. Kompetencat nuk përbëhen nga një grup “gjërash” që studentët duhet t'i mësojnë e që janë të ndryshme nga tërësia e njohurive tradicionale që studentët i mësojnë. Kompetencat bazohen në këtë dije dhe e përmbajnë atë. (shif. manualin nr. 1)
2. Përgjithësisht kompetencat duhet të jenë të matshme në formë direkte dhe të performohen në mënyrë të dukshme.

Grafiku më poshtë synon të ilustrojë rolin e kompetencave në kurrikulë:



Mund të identifikojmë dy grupe kryesore të kompetencave: kompetenca të përgjithshme që mund të aplikohen për çfarëdo fushe të dijeve dhe kompetenca specifike që janë të veçanta për çdo fushë të dijeve. Për shembull:

Kompetencat e përgjithshme përfshijnë:

- aftësinë për të vlerësuar qëndrueshmërinë e propozimeve dhe veprimeve vetanake;
- aftësinë për të mbledhur dhe selekcionuar informatat në mënyrë efektive

Kompetencat e veçanta përfshijnë:

- aftësinë për të dizajnuar sisteme kontrolli dhe makineri automatike industriale (inxhinieri)
- aftësinë për të vlerësuar cilësinë e pejzazhit dhe hapësirën përreth të ndonjë zone të caktuar, duke i vënë në kontekst si faktorët natyrorë ashtu edhe ata kulturorë (gjeografi)

Nga ky koncept i mësimdhënies duhet të hartohet lista e kompetencave që një universitet beson se duhet t'i ketë secili student në të mbaruar të studimeve. Nga këtu del se programet e studimeve në nivelin Master e kanë listën e vet të kompetencave, që përmban një sërë kompetencash të përgjithshme dhe një tjetër të kompetencave të veçanta. Kompetencat e përgjithshme janë të njëjta për kurse të ndryshme të kualifikimit në një universitet të caktuar. Kompetencat e veçanta janë më të shumta në numër se të përgjithshmet meqë ato e përcaktojnë përmbajtjen aktuale dhe specifikat e dijeve për çdo të diplomuar të një programi të caktuar Master.

8. Katalogu i kompetencave – Pse është i rëndësishëm?

Josep Juandó i Bosch, Magüi Pérez Cabaní, Universiteti i Gironës, Girona

Një listë e kompetencave të përgjithshme dhe atyre të veçanta e prerë sipas një programi të caktuar universitar paraqet qëllimet e të mësimnxënies. Lista mund të lexohet në mënyrë të ndryshme:

- ajo paraqet profilin e programit kualifikues dhe atë të të diplomuarit të ardhshëm;
- ajo e shpreh përkushtimin e një universiteti ndaj shoqërisë, shpreh atë që ai universitet e paraqet si rezultat të të nxënës;
- ajo është udhërrëfimi për të gjithë aktivitetin mësimor të programit;
- ajo është pika e nisjes dhe e përfundimit të procesit të mësimdhënies e mësimnxënies. Kurset akademike, lëndët dhe aktivitetet e mësimnxënies do të planifikohen me fokus në kompetenca dhe në rezultatet e të nxënës të cilat do të testohen sipas kompetencave, d.m.th. sipas shkallës së përvetësimit të kompetencës së propozuar nga ana e studentit.

9. Katalogu i kompetencave – Çfarë përmban ai?

Josep Juandó i Bosch, Magüi Pérez Cabaní, Universiteti i Gironës, Girona

Lista e kompetencave duhet të përmbajë kompetencat e përgjithshme dhe të veçanta që një student duhet t'i ketë përvetësuar. Së bashku ato e përbëjnë profilin e të diplomuarit të ardhshëm.

Në mënyrë më eksplicite seria e kompetencave duhet të përmbajë gjithë dijet specifike të një programi të caktuar. Për më tepër, të diplomuarit duhet të jenë në gjendje për t'i përdorur

kompetencat e fituara. Kësisoj, qasja në mësimdhënie të bazuar mbi kompetenca do të thotë të shkosh përtej dijes; kjo do të thotë të pëvetësosh edhe dijen e duhur por edhe të aftësohesh për ta përdorur atë dije në kontekst specifik.

Kjo është arsyeja përse secili universitet duhet të harxhojë kohë në fillim për të hartuar listën e kompetencave. Kur kompetencat të jenë përcaktuar dhe identifikuar, dija që vjen me përvetësimin e këtyre kompetencave duhet të korrespondojë me nevojat e shoqërisë.

Në mënyrë implicite lista e kompetencave përmban kriteret e testimit. Secila kompetencë duhet të jetë formuluar sipas termeve të testimit. Profesorët universitarë që planifikojnë të punojnë me kompetencat në klasë e kanë një instrument që e bën testimin e kompetencave më të lehtë. Nëse veprohet ndryshe është rrezik që kompetencat të formulohen në atë mënyrë që nuk lidhen me kurikulën po qëndrojnë sipër “duke pluskuar” dhe kështu bëhen thjeshtë dekor i kurikulës.

10. Nga kompetencat deri te aktivitetet e mësimnxënies

Josep Juandó i Bosch, Magüi Pérez Cabaní, Universiteti i Gironës, Girona

Shndërrimi i kompetencave në qëllime të mësimin nis me listën e kompetencave. Realizimi i këtyre qëllimeve të mësimin është sfidë për studentët. Rrjedhimisht, është e nevojshme që profesorët t'i bartin këto kompetenca nëpërmjet ligjëratave të tyre. Objektiva kryesore është që t'u mundësohet studentëve t'i përvetësojnë kompetencat që universiteti ka për synim t'i transmetojë me anë të kurikulës.

Përkthimi i kompetencave në aktivitete të mësimnxënies është një proces edhe kompleks po edhe i thjeshtë. Është proces kompleks ngaqë përfshin shumë hapa. Mirëpo, nëse zhvillohet në mënyrën e duhur ky proces është i thjeshtë. Bartja e kompetencave në klasë bëhet në dy nivele: hartimin e programit të përgjithshëm dhe hartimin e lëndëve të veçanta. Pastaj secila nga këto nivele përmban disa hapa.

Hartimi i programit të përgjithshëm përbëhet nga formulimi i kompetencave dhe pastaj nga analizimi i secilës kompetencë me qëllim të zbërthimit të saj në shkallë të ndryshme të kompleksitetit apo në komponentë. Në faqen tjetër kemi një shembull të mënyrës së zbërthimit në komponentë, të kompetencave të përgjithshme dhe një shembull të zbërthimit të kompetencave të veçanta.

Shembulli 1. Zbërthimi i kompetencës së përgjithshme “punë ekipore” në nivele të kompleksitetit:

Shkalla e kompleksitetit 1: Puna në ekipe dhe vlerësimi i proceseve të themeluara dhe i roleve që shtjellohet me ndihmën e një udhërrëfyesi të jashtëm.

Shkalla e kompleksitetit 2: Puna në ekipe (përfshi ekipe multidisiplinare) dhe vlerësimi i proceseve të themeluara dhe i roleve që shtjellohen, në mënyrë të pavarur si dhe ushtrimi i këtyre roleve (përfshirë lidërshtipin), duke i inkorporuar modifikimet që dalin nga reflektimet e përbashkëta.

Shkalla e kompleksitetit 3: Lidërshtip ekipor (përfshi ekipet që janë multidisiplinare dhe ndërkombëtare) dhe vlerësimi i proceseve të themeluara dhe i roleve që shtjellohen duke i inkorporuar modifikimet që dalin nga reflektimi i përbashkët.

Shembulli 2: Zbërthimi i kompetencës së veçantë “hartimi dhe rregullimi i fushave të mësimimit në kontekstin e diversitetit që adreson barazinë gjinore, paanësinë dhe respektimin e të drejtave njerëzore konform vlerave të arsimit qytetar” në shkallë të kompleksitetit.

Komponenti 1: Analizimi i principeve bazë të zhvillimit dhe sjelljes së shëndoshë.

Komponenti 2: Identifikimi i çrregullimeve, shmangieje, mangësive dhe vështirësive që e pengojnë mirëqenien e fëmijëve dhe zhvillimin e kënaqshëm të tyre në planin fizik dhe psikologjik.

Komponenti 3: Përdorimi i burimeve për promovimin e integritit arsimor të studentëve me nevoja të veçanta arsimore.


Komponenta 4: Njohja me diversitetin shoqëror dhe kultural dhe analizimi i nevojave të veçanta arsimore dhe personale.

Komponenta 5: Përdorimi i lojrave si burim mësimdhënieje për qëllim të mësimnxënies nga fusha e dijeve të përgjithshme, të vlerave qytetare dhe për strategji të trajtimit të diversitetit.

Rrjedhimisht, duhet vendosur se cilat lëndë të veçanta të një kurikule do të mund të trajtojnë komponentën e caktuar të secilës nga kompetencat. Një opcion interesant në këtë pikë, që njëherësh e bën kurikulën më të integruar dhe më transversale, është që secila kompetencë të lidhet me më shumë se një lëndë dhe kjo të bëhet në kohë të ndryshme të gjatë kurrikulës. Për të ilustruar se si funksionon kjo gjë mund të përdoret një tabelë si kjo më poshtë:


Kualifikimi: _____

Kompetenca e lidhur me kualifikimin →	C1	C2	C3	C4	C5		CN
Lëndët e kualifikimit ↓							
A1	X		X			X	
A2		X	X		X		
A3		X		X			
	X		X		X		X
AN		X		X		X	



Procesi i planifikimit mund të nisë për secilën lëndë. Së pari, secila lëndë e ka të caktuar punën që kërkohet për të arritur një kompetencë të caktuar. Së dyti, është detyrë e secilit profesor universitar të sajë aktivitetet e mësimdhënies që bazohen në përmbajtje të caktuara të lëndës. Strategjia e mësimdhënies dhe didaktika duhet të zbatohen në atë mënyrë që secili aktivitet që bëhet me studentë të përshtatet me ndonjërin prej kompetencave që duhet zhvilluar, qoftë ai me karakter shpjegues që bëhet në klasë, qoftë mësim praktik, detyrë leximi apo çfarëdo ushtrimi tjetër. Më tutje, bashkëpunimi mes profesorëve të një programi kualifikues është me rëndësi thelbësore për të garantuar përvetësimin e kompetencave si dhe për të përmirësuar koherencën e përgjithshme të programit.

Një program kompjuterik i menaxhimit të mësimdhënies mund të ndihmojë për organizimin dhe vizualizimin e proceseve dhe rezultateve të cilat më pastaj mund të shprehen në formë të lëndëve dhe kompetencave. Diagrami në vazhdim ilustron procesin e transferit të kompetencave në klasë, që në mënyrë të veçantë përfundon me përmbajtje dhe me kohën që harxhohet për te.



Strategjia mësimnxënies së bazuar në kompetencë në nivel universiteti dhe fakulteti

Alexandra Mayr, Universiteti i Alicante, Alicante

1. Hyrje

Ky shkrim e ilustron mënyrën e integritit të konceptit të mësimnxënies së bazuar në kompetencë në programet e studimit dhe në metodologjitë e mësimdhënies në Universitetin e ALikantes (UA) në Spanjë. Për të paraqitur sfondin e integritit të mësimnxënies së bazuar në kompetencë, shkrimi jep një ekspozitë të shkurtër të kuadrit relevant të politikave kombëtare dhe regjionale të Spanjës. Kontributi më i rëndësishëm i këtij shkrimi është thjeshtëzimi i strategjive, mekanizmave dhe roleve të aktorëve të ndryshëm që u përfshinë në procesin e implementimit të konceptit të mësimdhënies së bazuar në kompetencë në nivelin institucional dhe të fakultetit. Në këtë menyrë ky shkrim do të paraqesë ide dhe udhëzime për universitetet e tjera që synojnë të implementojnë mësimnxënien e bazuar në kompetencë.

2. Përcaktimi i kompetencave

Korniza e makro nivelit

Procesi i Bolonjës dhe krijimi i hapësirës së arsimit të lartë europian (EHEA) paraqet sfida të rëndësishme për universitetet e Europë, veçanërisht atë të adaptimit të programeve studimore me nevojat e tregut të punës dhe të integritit të mësimnxënies së bazuar në kompetenca për secilin kurs që ofrohet.

Si përgjigje ndaj kërkesave të procesit të Bolonjës dhe të hapësirës së arsimit të lartë europian (EHEA), qeveria spanjolle ka inicuar një numër reformash të rëndësishme të sistemit universitar (p.sh. Ley organic 4/2007, 1393/2007), që u kërkon univesiteteve të kontrollojnë programet e tyre të studimit dhe që i ndërton kërkesat zyrtare për cilësi dhe akreditim të programeve të reja studimore.

Me qëllim për të siguruar udhëzime praktike për universitetet në këtë proces, Agjencioni Kombëtar Spanjol për Vlerësimin e Cilësisë dhe për Akreditim (ANECA - Agencia Nacional de la Evaluación de la Calidad y la Accreditación) ka përpunuar një seri udhëzuesish, të ashtuquajturit “librat e bardhë” (Libros Blancos), me rekomandime praktike për ridisejnimin e programeve studimore duke ndjekur kërkesat e Bolonjës. Librat e bardhë janë rezultat i bashkëpunimit mes rrjetit të universiteteve spanjolle dhe aktorëve të tjerë, të përkrahur nga ANECA, me qëllimin e veçantë për të kryer hulumtime dhe për të propozuar udhëzime praktike për standardet e programeve të studimeve postdiplomike, si kompetencat, objektivat, metodologjitë, kriteret e vlerësimit etj.

Librat e bardhë ishin përpunuar dhe kishin bazë të fortë në këto aspekte: analizë komparative të programeve të studimit respektiv që ofrohen nga universitete e vendeve të tjera të bashkimit europian, karakteristikat kryesore dhe kërkesat e veçanta të kualifikimeve europiane, rezultatet e studimeve për inkuorporimin e të diplomuarve universitarë në tregun e punës, analiza e kompetencave dhe profileve profesionale si dhe apekte tjera të rëndësishme. Modelet e programeve kualifikuese të përcaktuar në librat e bardhë ishin zhvilluar me punë kolaborative të aktorëve të ndryshëm (universitet, biznes, studentë).

Rasti i diplomës Bachelor për pune sociale – Universiteti i Alicante kishte pjesmarrje aktive për zhvillimin e Librit të bardhë me 2003-2004:

Konkursi kombëtar për projekte: Financimi i granteve i sigurua nga ANECA për hartimin e kurikulës për Diplomë bachelor në punë sociale.

- Formimi i një këshilli të përzier: 7 përfaqësues nga Bordi Kombëtar i Drejtorëve, 4 anëtarë nga Bordi Kombëtar i Shoqatave të Punëtorëve Profesional social, 3 përfaqësues nga studentët.
- Hartimi dhe koordinimi i Këshillave/Punës në universitete
- Koncenzusi në Asamblenë e përgjithshme (rrjeti i hulumtimit me 32 universitete)

<http://www.aneca.es/Documentos-y-publicaciones/Otros-documentos-de-interes/Libros-Blancos>

Konkluzionet kryesore të projektit:

- Në Spanjë, procesi politik për konvergencë EHEA është shumë i ngadalshëm (ka përfunduar 2010-2011)
- Në rastin e kualifikimeve për pune sociale: procesi i hartimit për Bachelor për Punë Sociale është një model i mirë praktik me koncensus dhe është hartuar nga ana e përfaqësuesve të universitetit dhe sektorit profesional.
- Si rezultat, Libri i Bardhë propozon një profil të ri arsimor që bazohet në profilin e detajuar profesional (kompetenca)

Me qëllim që të arrihen kompetencat dhe objektivat e reja të mësimnxënies u bë e qartë se ka nevojë për:

- përfshirje më të madhe të trajnimit praktik përmes projekteve dhe praktikës profesionale;
- promovimin e hulumtimit në punë sociale;
- lidhje më të mirë mes teorisë dhe praktikës.

Implikimet: marrëdhëniet mes universitetit dhe punëtorëve socialë profesional duhet të forcohet edhe më shumë, ka nevojë për metoda të reja të mësimdhënies dhe për mjete të reja didaktike; ka nevojë për instruktorë për të punë praktike në lëmin e punes sociale.

Librat e bardhë janë dëshmuar si mjet shumë i rëndësishëm për univeristetet spanjolle, të cilat i përdorin informatat që këto libra përmbajnë si model reference për zhvillimin e programeve të reja studimore

Korniza e nivelit institucional dhe aktorët e përfshirë

Me qëllim të përcaktimit dhe vërtetimit të kompetencave që duhet përvetësuar në kuadër të secilit program të kualifikimit, këshillat e fakulteteve të caktuara për këtë aktivitet të Universitetit të Alicantes u inkurajuan për përfshirjen aktive të këtyre aktorëve dhe entiteteve:

Entitetet e jashtme universitare që kanë bashkëpunuar me UA:

- Oda ekonomike lokale
- Departamenti për burime njerzore i ndërmarrjeve regjionale
- Administrimi publik

Departamentet dhe entitetet e brendshme të universitetit:

- Profesorët, hulumtuesit dhe shefat e departamenteve (koordinatorë, rrjete dhe grupe punuese)
- Njësia Teknike e universitetit për vlerësimin e cilësisë
- Fondacioni i përgjithshëm i Universitetit të Alicante (UAFG)
- Qendra për karrierë dhe shërbime këshillimore për punësim, për studentët e UA
- Observatori i Universitetit për Vendorsjen e Punës
- Fondacioni i ndërmarrësisë universitare
- Zyra e transferit
- Ish studentët

Karakteristikat e entiteteve universitare që luajnë një rol për përcaktimin e kompetencave të bazuara në nevojat e tregut të punës

Fondacion i përgjithshëm i UA	<ul style="list-style-type: none"> • Zona e ndërveprimit mes UA dhe shumë firmave. • Trainimi i prerë sipas nevojave të sektorit privat (I bazuar në kërkesat e tregut) që ka për synim profesionalistët. • Shërbimet e punësimit dhe studimet e tregut të punës. www.uafg.es
Njësia teknike për vlerësimin e cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i procesit të vlerësimit të aktiviteteve të mesimdhënies • Planifikimi dhe realizimi i studimeve për integrimin e punës, satisfacionin e studentëve, të të diplomuarve personelit etj http://utc.ua.es
Qendra e UA për karrierë dhe shërbime këshillimore për studentë	<ul style="list-style-type: none"> • Facilitimi për vendorsjen e studentëve dhe të diplomuarve nga UA • Këshillime vokacionale per student • Studime mbi shkallën e harmonizimit mes kërkesave dhe ofertës për diploma universitare. www.gipe.ua.es

Observatori universitar për vendosje të punës	<ul style="list-style-type: none">• Marrëveshjet me ndërmarrjet dhe administratën publike lidhur me punësimin dhe praktikën profesionale• Ngjarjet për rrjetëzimin e universitetit me ndërmarrjet• Trainimi i aftësive dhe strategjive për kërkimin e punës www.insercionlaboral.ua.es
--------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Katalogu i kompetencave i UA

Është bërë marrëveshja, në nivel institucional që siguron se çdo diplomë e ofruar në UA i pajisë studentët me një sërë kompetencash, sipas klasifikimit në vijim:

- Kompetencat e përgjithshme që lidhen me kualifikimin
- Kompetencat e përgjithshme transversale (kompetenca të zakonshme që duhet fituar në kuadër të të gjitha diplomave të ofruara në UA):
 - o CGUA1: aftësi për përdorimin e gjuhëve të huaja
 - o CGUA2: aftësi për përdorimin e kompjuterit dhe për komunikim
 - o CGUA3: aftësi të theksuara të komunikimit me gojë dhe me shkrim
 - o Kompetencat e veçanta

Shembull: Kompetencat që lidhen me diplomën në ekonomi që ofrohet në UA gjatë vitit akademik 2010/2011

Kompetencat e përgjithshme (CG)

- CG1: aftësia për të gjetur dhe analizuar informacionin
- CG2: aftësia për punë ekipore
- CG3: aftësia për të mësim autodidact
- CG4: aftësia për përdorimin e kriterëve profesionale bazuar në përdorimin e instrumentëve teknikë për analizimin e problemeve.
- CG5: aftësia për të marrë vendime duke përdorur dijen efituar për situatë praktike
- CG6: marrja e informacioneve të rëndësishme nga të dhënat në formën që është e pamundur për ndonjë amator.
- CG7: përkushtim etik dhe përgjegjesi shoqërore në punë, duke respektuar rrethin, duke qenë i vetëdijshëm dhe duke kuptuar rëndësisë e respektimit të të drejtave njerzore, mundësive të barabarta për burra dhe gra, mundësitë e përgjithshme për njerëz me invaliditet dhe respektim të vlerave të kulturës paqësore me vlera demokratike.
- CG8: analizimi i problemeve me anë të rezonimit kritik, pa paragjykim, saktë dhe ashpër
- CG9: aftësi për sintetizim.

Kompetencat e përgjithshme të përvetësuara në Universitetin e Alicante (CGUA)

- CGUA1: Lexim dhe komunikim në një guhë të huaj, veçanërisht në anglisht, në një mjedis profesional.
- CGUA2: Përdorimi të I.T. kompjuterike dhe të mjeteve të teknologjisë së komunikimit, si një gjë të natyrshme për të gjitha veprimet profesionale.
- CGUA3: Aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim.

Kompetenca të veçanta (CE)

- CE1: Kontributi për menaxhim të saktë të alokimit të burimeve si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.
- CE2: Identifikimi dhe anticipimi i problemeve relevante ekonomike në lidhje me alokimin e burimeve në përgjithësi, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.
- CE3: Sjellja e qasjes racionale për analizimin dhe përshkrimin e cilitdo aspekt të realitetit ekonomik.
- CE4: Evaluimi i pasojave të opcioneve të ndryshme për veprim dhe zgjedhjen e opcionit më të mirë sipas objektivave të paracaktuara.
- CE5: Nxjerrja e raporteve të ekspertëve për situatat e caktuara ekonomike (ndërkombëtare, kombëtare apo regjionale) apo të sektorëve ekonomikë.
- CE6: Draftimi i projekteve të manaxhimit ekonomik në nivel ndërkombëtar, kombëtar apo regjional.
- CE7: Involvimi në manaxhim biznesi.
- CE8: Identifikimi i burimeve të informacionit relevant ekonomik dhe të përmbajtjes së tyre
- CE9: Të kuptuarit e institucioneve ekonomike dhe të mënyrës së funksionimit të ekonomisë si në planin teorik ashtu edhe në atë formal.
- CE10: Aftësia për të aplikuar dijen dhe shkathtësitë e përvetësuara për zgjedhjen e problemeve teorike dhe të ekonomisë së aplikuar.
- CE11: Shkathtësia analitike për zhvillimin e kornizave teorike që e thjeshtëzojnë studimin e ekonomisë reale dhe aftësia e përcaktimit të nivele të duhura të abstrakcionit gjatë studimit të pyetjeve të ndryshme ekonomike.

3. Implementimi i mësimnxënies me bazë në kompetenca në Universitetin e Alicante

Një pamje e shkurtë e procesit

Më poshtë po japim një vështrim të përgjithshëm të strategjisë që ka ndjekur Universiteti i Alicante për të integruar konceptet e mësimnxënies mbi bazën e kompetencave në programet e studimit:

- Për secilin program kualifikimi të cilin do nivel që ofrohet nga ana e universitetit, fakultetet duhet të hartojnë një program studimi shumë të hollësishëm që përfshin objektivat dhe metodologjitë e mësimnxënies të bazuar në kompetenca dhe që ndjek strukturën e përcaktuar me rregulloren e universitetit për zbatimin e studimeve pasuniversitare e cila është përgjegjesi e prorektorëve përkatës.
- Kompetencat: Kompetencat që lidhen me secilin program kualifikimi janë përcaktuar në Libros Blancos që ANECA ka hartuar si orientim për të gjitha universitetet spanjolle. Tjetër informacioni shtesë që ndihmon përcaktimin e kompetencave mbledhet nga studime, analiza dhe feedback nga shumë aktorë të ndryshëm qoftë nga universiteti apo nga diku tjetër.
- Secili fakultet i UA duhet të hartojë dhe të botojë programet e reja të kualifikimit si edhe udhëzimet e mësimdhënies për secilin kurs të ofruar (“Udhërrëfyesi i mesimdhënies” (Teaching Guide)). Hartimi i këtyre dokumenteve mbikqyret nga Njësia Teknike e Vlerësimit të Cilësisë që ka për detyrë të ndjekë procesin e kontrollit intern të cilësisë dhe të miratimit, që universiteti e zbaton përpara se programet të paraqiten për akreditim final në Ministrinë e Arsimit të Spanjës.

Mjetet praktike që personeli i fakultetit i ka në dispozicion për integrimin e mësimnxënies me bazë në kompetencë në programet e reja të studimeve

Universiteti i Alicante duke u nisur nga këndvështrimi i integritetit efektiv të metodës së mësimnxënies me bazë në kompetenca në të gjitha programet e studimeve nëpër të gjitha fakultetet ka promovuar një sërë iniciativash dhe mjetesh. Mjetet më të rëndësishme janë ilustruar në vijim:

- **Librat e bardhë / Libros blancos** - Korniza e propozuar nga Libros Blancos shërben si pikënisjeje për përcaktimin e kompetencave për secilin program kualifikimi në Universitetin e Alicante.
- **Rregullorja e Universitetit** - Në përputhje me kërkesat e hapësirës së arsimit të lartë evropian (EHEA) dhe me reformat e ligjeve kombëtare dhe regjionale të Spanjës, prorektori përgjegjës i Universitetit të Alicante ka botuar një rregullore e cila i vendos procedurat që duhet ndjekur gjatë procesit të ndërtimit të programeve të reja kualifikuese, që fokusohen në mësimnxënien e bazuar në kompetenca. Kjo rregullore vendos strukturën e përgjithshme të kualifikimeve në UA, përcakton elementet e ndryshëm që duhet të përfshihen në projektpropozimet e programeve të reja të kualifikimit (përshkrimin, arsyetimin, objektivat, qasjen e studentëve dhe pranimin e tyre, planin e punës), procedurat e përpunimit dhe ato të miratimit të programeve të reja studimore, metodat e evaluimit të kompetencave që i përvetësojnë studentët etj.

- **Udhërrëfyeni i mësimdhënies për të gjitha kurset e ofruara** - “Instituti i Arsimit Shkencor” (Instituto de Ciencias de la Educacion) mori detyrën për të hartuar dhe botuar një “Udhërrëfyes për mësimdhënie” që do të jetë asistencë shtesë praktike për të gjithë personelin e fakulteteve që zhvillojnë programe të reja të studimit dhe që do të përdoret si model për të gjitha kurset e ofruara në universitet.

Personeli i fakulteteve duhet të hartojë dhe të botojë “Udhërrëfyes për Mësimdhënie” që bazohet në këtë model i cili jep informacion të detajuar të përmbajtjes së kurseve të programit, në mënyrë specifike e shpreh marrëdhënien e kompetencave me objektivat e mësimnxënies, e tregon planin e detajuar të punës dhe aktiviteteve, paraqet metodat e propozuara për evaluimin e rezultateve të të nxënit dhe përvetësimit të kompetencave etj.

Udhërrëfyeni për mësimdhënie në secilin kurs do të ilustrojë informatat si në vijim:

- Kontributi i kursit për profilin profesional që duhet zhvilluar në kuadrin e një programi të caktuar kualifikues dhe për zhvillimin e kompetencave që lidhen me atë program; roli i kursit brenda programit studimor dhe marrëdhënia me kurset e tjera.
- Kompetencat
- Kompetencat e përgjithshme që duhet të zhvillohen në kuadër të secilit program studimi përcaktohen si në vijim:
 - Kompetencat instrumentale: u mundësojnë studentëve përdorimin e dijes së fituar si instrument për arritjen e objektivave të tjera
 - Kompetencat ndërpersonale: aftësia për të punuar në ekip dhe për bashkëveprim shoqëror dhe bashkëpunim.
 - Kompetenca sistematike: aftësia për të pasur vizion, për të integruar dhe për të lidhur pjesë të ndryshme të cilitdo sistem; organizatë dhe ndërmarrësi
- Kompetenca specifike sipas programeve studimore zyrtarisht të akredituara
- Objektivat dhe rezultate e të xënit në raport me kompetencat specifike:
 - Objektiva njohëse apo kognitive
 - Objektiva instrumentale
 - Qëndrimet
- Përmbajtjet e mësimnxënies
- Metodologjitë e mësimdhënies
- Metodatat e evaluimit
- Projekti “Rrjetëzimi i hulumtimit të mësimdhënies universitare” (‘Redes de Investigacion en docenciauniversitaria’)

Projekti që është inicuar me iniciativën e Prorektorit për Planifikim Strategjik dhe Vlerësim të Cilësisë krijon lloje rrjetëzimesh ku aktorë të ndryshëm punojnë së bashku me qëllim të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në Universitetin e Alicante, duke u nisur nga mësimnxënia e bazuar në kompetencë dhe nga kërkesate e hapësirës së arsimit të lartë europian (EHEA). Në mënyrë më të veçantë, këto rrjetëzimet kanë për qëllim

të promovojnë hulumtimet dhe reflektimet për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke inkurajuar në të njejtën kohë edhe pjesmarrjen e studentëve dhe aktorëve të tjerë, me synim për të zgjeruar perspektivat dhe për të gjetur metodologji të reja më të avancuara të mesimdhënies për zhvillimin e kompetencave të kërkuara. Këto rrjetëzime përbëhen nga tetë deri dhjete anëtarë dhe mund të përfshijnë staf akademik, studentë si dhe personel nga ata të menaxhmentit apo administratës.

Rrjetëzimet synojnë të krijojnë një platformë për mësimdhënësit universitarë që e mundëson shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin profesional që promovojnë hulumtimin lidhur me metodologjitë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Aktivitetet dhe rezultatet e rrjetëzimeve i raportohen Prorektorit për Planifikim Strategjik dhe Vlerësim të Cilësisë në mënyrë periodike.

Njëherë në vit organizohet një konferencë në kuadrin e projektit për rrjetëzimin e mësimdhënies, me qëllim të promovimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave mes rrjeteve të ndryshme. Me qëllim të promovimit të bashkëveprimit të mëtejshëm të shkëmbimit të përvojave dhe dijes në mes mësimdhënësish në kuadër të projektit të rrjetëzimit të hulumtimit të mësimdhënies u krijua një blog. (<http://blogs.ua.es/redesice/informacion/>).

Projekti i rrjetëzimit të mësimdhënies ka më shumë se tetë vite që funksion dhe është dëshmuar të jetë një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjive të mësimdhënies. Në vitin 2010 Universiteti i Alicante kishte 76 rrjete aktive ku përfshiheshin më shumë se 774 anëtarë (staf akademik dhe studentë).

- Projekti i trajnimit të mësimdhënësve

Për Universitetin e Alicante, trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i aftësive të mësimdhënësve universitarë është një nga kërkesat thelbësore në mënyrë që të sigurohen programe cilësore të kualifikimit dhe që të mundësohet përfshirja e mësimnxënies së bazuar në kompetencë. Prandaj, universiteti përmes “Institutit për Arsimin Shkencor” ofron një program trajnimi që u përgjigjet kërkesave për ritrajnim të mësimdhënësve universitarë, veçanërisht lidhur me çështjet e inovacionit, teknologjive të reja dhe metodologjive të reja të mësimdhënies. Ky program zbatohet në koordinim me aktivitetet trajnuese që i ofron qeveria regjionale për mësimdhënësit universitarë. Profesionistët nga universitetet dhe biznesi mbajnë kurse trajnimi në këto fusha:

- Vlerësimi, metodologjitë e mësimdhënies, planifikimi (në fusha të përgjithshme dhe të veçanta)
- Integrimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie
- Mjetet për kërkim të punësimit dhe informacioni i azhornuar për tregun e punës
- Hulumtimi shkencor, komunikimi dhe rrjetëzimi
- Kompetencat bazë të zhvillim profesional
- Kurse për tema të veçanta, të organizuara sipas kërkesës

4. Përfundim

Universiteti i Alicante, si shumë universitete tjera të Europës, ka nisur integrimin e mësimnxënies së bazuar në kompetenca në programet e studimit universitar i nxitur nga procesi i Bolonjës dhe krijimi i hapësirës së arsimit të lartë europian (EHEA). Meqë vendimet e politikave spanjolle u morën me vonesë, implementimi i programeve të reja të kualifikimit, me fokus në mësimnxënie të bazuar në kompetenca, arritën të bëhen efektive vetëm në vitin akademik 2012/2011. Gjatë procesit të përgatitjes për implementimin e sistemit të ri kualifikues në pajtim me kërkesat e hapësirës së arsimit të lartë europian (EHEA), u ndërmorën disa iniciativa në nivel kombëtar institucional që sollën rezultate të shkëlqyera të cilat ndikuan që procesi i tranzicionit të jetë efikas dhe efektiv. Gjurmët e këtyre iniciativave shkojnë deri te fakti se UA kultivon një raport të gjatë me sektorin privat dhe për shumë vite me radhë bën studimin e tregut të punës me qëllim që programet e veta studimore t'i adaptojnë dhe t'i afrojnë sa më shumë që të jetë e mundur me nevojat reale të të diplomuarve. Në këtë mënyrë, të diplomuarve krijohet mundësia për të qenë të suksesshëm në tregun e punës. Megjithatë, tash për tash nuk mund të nxjerrim përfundime substanciale për përvojat e UA në mësimnxënie dhe vlerësim të kompetencave sipas kërkesave të hapësirës së arsimit të lartë europian (EHEA). Sidoqoftë mjetet e krijuara për përcaktimin dhe integrimin e kompetencave në programet kualifikuese të UA sikur u tha më lartë mund të jenë të dobishme për universitetet tjera që synojnë të integrojnë mësimnxënien e bazuar në kompetenca.

Si përmbledhje themi se përvoja e UA sugjeron se faktorët në vijim janë me rëndësi të veçantë për integrimin e mësimnxënies së bazuar në kompetencë, në universitet.

- Përcaktimi dhe komunikimin i qartë i proceseve, përgjegjësi dhe kornizave kohore për integrimin e mësimnxënies së bazuar në kompetencë;
- Lehtësimi i përfshirjes së aktorëve në përcaktimin dhe vlerësimin e kompetencave, në veçanti të përfaqësuesve nga organizatat profesionale dhe nga sektori privat;
- Promovimi i kooperimit dhe krijimi i platformës për shkëmim të përvojave, mësimnxënies dhe rrjetëzimit për stafin akademik (projekte rrjetëzimi, blogje, takime, konferenca);
- Ofrimi i trajnimeve të targetuara për stafin akademik që ata të jenë të përgatitur për të adaptuar metodologjitë e mësimdhënies me kërkesat e reja;
- Propozimi për udhëzime praktike konkrete, derisa në të nejtën kohë lejohet hapësirë për fleksibilitet dhe për ide inovative.

Burimet

http://www.ua.es/es/presentacion/vicerrectorado/vr.estudis/grado_posgrado/index.html
<http://www.aneca.es/Documentos-y-publicaciones>
http://www.investigacion-psicopedagogica.org/revista/articulos/15/english/Art_15_267.pdf
<http://rua.ua.es/dspace/bitstream/10045/13199/32/PROPUESTAS%20CAP.%2032.pdf>
http://rua.ua.es/dspace/bitstream/10045/13540/1/ALT_16_01.pdf
<http://library.iated.org/view/CANTEROVICENTE2011ANE>
http://www.investigacion-psicopedagogica.org/revista/articulos/15/english/Art_15_267.pdf
http://www.eassw.org/conferences/Dubrovnik/Presentations/6DubravaSection_II/Session4W7/A_New_SW_%20Education_in_Spain.pdf

Katalogjet e kompetencave dhe përdorimi i tyre praktik

Josep Juandó i Bosch, Magüi Pérez Cabaní, Universiteti i Gironës, Girona

1. Koncepti i kompetencës – si përcaktohet dhe cila është vlera që e paraqet për krijimin e lidhjeve me shoqërinë

Në kontekstin e hapësirës së arsimit të lartë europian (EHEA), termi “kompetencë” qëndron në thelb të terminologjisë së përdorur në lidhje me mësimdhënien. Paralel me të qëndron termi tjetër “rezultatet e të nxënit” (learning outcomes) që paraqet një koncept mjaft të njohur dhe shumë të pranuar. Pastaj edhe “kornizat e kualifikimeve” gjithashtu paraqesin një aspekt të rëndësishëm kur diskutojmë termin “kompetencë” në raport me hapësirën e arsimit të lartë europian (EHEA). Pikë kryesore e referimit për “kornizat e kualifikimeve” është Korniza Europiane e Kualifikimit.

Nevoja për të arritur transparence të plotë dhe krahasueshmëri mes sistemeve arsimore europiane është identifikuar si një nga qëllimet themelore të procesit të Bolonjës. E tillë është edhe nevoja për krahasueshmërinë e rezultateve dhe kualifikimeve.

Konceptet e përdorura (kompetenca, rezultatet e të nxënit, korniza europiane e kualifikimeve) janë konceptet që duhet të kombinohen për të arritur objektivat e transparences dhe të krahasueshmërisë që për synim të fundit e kanë promovimin e lëvizshmërisë mes studentëve dhe punëtorëve dhe kësisoji të forcojnë identitetin Bashkimit Europian duke inkurajuar dije të përbashkëta, komunikim të ndërsjellë dhe kohezion reciprok.

Që konceptet e përmendura të mund të organizohen në mënyrë efektive, është me rëndësi thelbësore që të pajtohemi rreth domethënies së saktë të tyre. Kësisoji, cilido qoftë kuptimi që konceptet, “kompetencë” apo “rezultatet e të nxënit” e shprehin, që të gjithë aktorët e përfshirë në proces do të flasin për koncepte të njejta. Arritja e koncenzusit lidhur me domethënien e këtyre koncepteve është me rëndësi thelbësore për të mundësuar një diskurs të përbashkët dhe arritje të rezultateve solide.

Bazuar në përvojën tonë propozojmë një interpretimi specifik të këtyre koncepteve si dhe një definim të saktë të raportit mes tyre, me qëllim të krijimit të një modeli të drejtperdrejtë të pakomplikuar dhe të lehtë për t’u kuptuar që është i pranueshëm për komunitetin universitar, që do mund të bëhej “kuzhine” ku mund të testohen “recetat” e procesit të Bolonjës. Nëse nuk përdorim emërtimet e njejta për të njejtit përbërës dhe për të njejtat procedura ndodhë që të mos jemi në gjendje për ta tretur ushqimin e servuar.

Ndodh mjaft shpesh që nëpër mbledhje të personelit mësimdhënës, të fillojnë diskutimet e të mos merren parasysh këto detaje prandaj është tejet e rëndësishme që në fillim të sqarohet interpretimi i termeve me të shpeshtë në mënyrë që të sigurohemi se po nxjerrim kuptimet e njejta dhe kështu mund ta bartim diskutimin në drejtimin e duhur. Komisioni Europian, me rastin e përcaktimit dhe nxjerrjes së rekomandimeve për zbatimin Kornizës Europiane të Kualifikimit (European Qualifications Framework (EQF)) pati thënë: “Thelbi i Kornizës Europiane të Kualifikimit lidhet me tetë nivele reference që përshkruajnë atë që nxënësi e di, atë që ai e kupton dhe atë që është në gjendje ta bëjë, “rezultatet e të nxënit”.

Në pajtim me këtë qasje që zbatohet për “rezultatet e të nxëniet” grupi i hulumtimit si premisë të parë e merr atë që Jacques Delors në raportin: “Mësimnxënia: pasuria e brendshme” e përcakton si një nga katër themelet e arsimit, që nga pikëpamja e mësimdhënies është më interesantja dhe nga aspekti i vlerësimit e i kualifikimit, fillon që nga stadi i parë i planifikimit, e kjo është: të mësosh për të bërë. Argumenti kryesor është se të mësosh për të bërë është një gjë e cila mund t’u mësohet të tjerëve dhe që mund të vlerësohet në mënyrë direkte. Për shembull, është e mundur që në mënyrë shumë bindëse të përcaktohet nëse një student di të flasë para publikut, nëse ai di të krahasojë dy sisteme të ndryshme politike apo nëse mund të punojë në ekip. Gjatë procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit të të mësuarit është e mundur që në mënyrë të tërthortë të vlerësohet se deri në çfarë shkalle kanë arritur studentët që me të vërtetë ta ruajnë njohurinë e fituar (“shtylla” e parë e raportit të Delor). Për më tepër, kur njerëzit nisin për të bërë diçka dhe zhyten në një kontekst të caktuar, ata lidhen me këtë kontekst në mënyrë të veçantë dhe të dukshëm (shtylla e tretë e raportit të Delor), po gjithashtu e tregojnë edhe vetveten se çfarë janë me të vërtetë (shtylla e katërt e Delor).

Shkurt, të mësosh për të bërë e përfshin mësimnxënien, i bën studentët të mësohen për të jetuar së bashku dhe e tregon mënyrën për të mësuar si të jesh. Për këtë arsye në këtë propozim kompetencash, koncepti thelbësor i procesit të Bolonjës identifikohet me të mësosh për të bërë. Kjo është një formë komplekse e të mësuarit për të bërë që varet nga kombinimi i shumë faktorëve, po që në fund të fundit mund të matet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qartë.

Grupi hulumtues e gjen këtë interpretim të përshtatshëm sepse ai në të njëjtën kohë gjithashtu krijon një lidhje kuptimplote me shoqërinë në përgjithësi. Shoqëria bashkëkohore europiane kërkon të ketë një marrëdhënie të afërt me universitetet e veta. Koncepti çelës i kësaj marrëdhënie është koncepti i kompetencës. Universitetet duhet të dinë se cilat janë ato kompetenca që i kërkon shoqëria të cilës i shërbejnë dhe pjesë përbërëse e të cilës janë, në aspektin e një procesi të matshëm i të mësuarit për të bërë. Kur këto kompetenca të jenë identifikuar atëherë qëllimi i mësimdhënies bëhet detyra për të siguruar që studentët do të përvetësojnë shkallën më të lartë të mundshme të kompetencës.

Ekspertët e ndryshëm kanë theksuar se është me rëndësi thelbësore që të përqëndrohemi në pyetjen se cilat janë kompetencat që duhet përvetësuar gjatë studimeve me qëllim që ato të mund të zbatohen drejtpërsëdrejti në faza më të vonshme në tregun e punës.

Nëse pranojmë një interpretim më të gjerë të konceptit të kompetencës, atëherë mund të themi se kompetenca mund të përcaktohet si diçka që përfshinë të gjitha fushat e mësimnxënies. Mjafton të themi se kompetenca përcaktohet si një objektivi që shkon përtej zotërimit të thjeshtë të dijes dhe synon të sigurojë zbatimin praktik të dijes së fituar. Koncepti i kompetencës mund të jetë i vlefshëm edhe në vetvete por ai gjithashtu është një koncept i dobishëm që e zgjeron fushën e dijes sonë. Vështruar nga kjo perspektivë, kompetencat mund të implikohen në çfarëdo fushe të mësimt.

2. Marrëdhënia mes kompetences dhe rezultateve të të nxënit si dhe me kornizën e kualifikimeve

Si u tha më lart, çështja kyçe e këtij shkrimi është marrëdhënia në mes të kompetencave, rezultateve të të nxënit dhe të kornizës së kualifikimeve. Kur koncepti i kompetencës të jetë pranuar ashtu si u definuar më lart dmth si objektive i procesit të mësimnxënies dhe rolit të vërtetë të arsimit, rezultatet e të nxënit mund të vështrohen në aspektin e kompetencës përkatëse dhe të shkallës në të cilën kompetencat janë përvetësuar në mbarim të studimeve. Kësisoj shkalla e përvetësimit të kompetencës duhet të pasqyrohet në kornizën e kualifikimeve. Tabela më poshtë synon të ilustrojë këtë marrëdhënie:

Procesi i mësimdhënies			Pas procesit të mësimdhënies
Fillimi i kursit	Gjatë kursit	Fundi i kursit	Përcaktimi i KOMPETENCES është element i krahasimit për kornizën kualifikuese.
KOMPETENCA është objektiva.	KOMPETENCA është pika e referimit për të gjithë procesin e mësimnxënies dhe të vlerësimit.	Shkallët e përvetësimit për secilën KOMPETENCE janë rezultatet e të nxënit.	

3. Mësimnxënia e bazuar në kompetencë përballë mësimnxënies së bazuar në përmbajtje

Mësimnxënia e bazuar në kompetencë nuk është një koncept që mund të zbatohet me lehtësi. Tradita e mësimnxënies së bazuar në përvetësimin e përmbajtjeve të caktuara është e gjatë dhe e rrënjosur mjaft mirë. Për këtë arsye mësimnxënia e bazuar në kompetencë kërkon një qasje me vizioni të qartë.

Thelbi i ndryshimit qëndron te fokusi i procesit të mësimnxënies. Në modelin e mësimnxënies së bazuar në përmbajtje, përmbajtja është thelbi i procesit dhe objektive e studentëve është që ta zotërojnë këtë përmbajtje. Pra është model që bazohet mbi transferin e kësaj përmbajtjeje. Në modelin e bazuar në kompetencë fokusi qëndron në përdorimin e përmbajtjes dhe në rëndësinë e kësaj përmbajtjeje në raport me shoqërinë dhe zhvillimin e saj. Ky model është më konstruktiv.

Ka edhe një përgjegje shumë të drejtpërdrejt për këtë argumentim, e ajo është vërejtja se studentët në universitet gjithnjë kanë përvetësuar dije (ky përvetësim pak a shumë varet nga sa shumë apo sa pak kanë studiuar ata apo edhe nga universitetet respektive) dhe kur i kanë përfunduar studimet, gjithnjë kanë pasur mend për të zbatuar këtë dije kudo dhe kurdo që ka qenë e nevojshme.

Padyshmi kundërargumenti është i vlefshëm. Diferenca në mes të këtyre dy paradigmave është kjo: në njërin rast institucioni arsimor synon të sigurojë dijen dhe aplikimin e saj ia “delegon” iniciativës individuale të të diplomuarit, ndërsa te modeli i ri aspekti i përdorimit të dijes trajtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe eksplicite gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në kuadër të vet institucionit arsimor.

Andaj, kjo në fund të fundit është çështje e fokusit, kështu fokusi në dijen e fituar vjen e bëhet fokusi në kompetencës, dmth përdorimi i kësaj dije specifike. Natyrisht është e qartë se dija nevojitet të jetë prezente përpara se të mund të përdoret, e kjo është e barazvlefshme me thënien se përmbajtja vazhdon të jetë baza e procesit të mësimnxënies.

Këto qasje shoqërohen me rolet të cilët janë të ndryshme për të dyja modelet:

	Modeli me bazë në përmbajtje	Modeli me bazë në kompetencë
Roli i studentit	Ta përvetësojë përmbajtjen	Të përvetësojë kompetencën (dmth pjesmarrje reflektive e konstruktive me bazë në përmbajtje)
Roli i ligjëruesit	Të japë mësim përmbajtjen	Të udhëzojë ndërtimin e kompetencës (të bazuar në përmbajtje)

Si përfundim mund të thuhet se mësimnxënia e bazuar në kompetencë nuk e përjashton mësimnxënien e bazuar në përmbajtje, por vetëm a bartë atë një hap më tej, derisa në të njejtën kohë i jep studentit përgjegjësi më të madhe.

Natyrisht që ka qendra të veçanta arsimore, universitete apo ligjërues që gjithnjë e kanë pasur këtë qasje ndaj procesit të mësimnxënies, për të gjithë ata kjo reformë nuk paraqet ndonjë ndryshim. Modeli i mësimnxënies që propozohet, në fakt mbështetet mbi principet ekzistuese që tashmë konsiderohen si valide dhe të transferueshme, gjë që sigurisht është e vërtetë edhe për shumicën e reformeve të cilësdo fushe. Këtu nuk bëhet fjalë për shpikje të qasjeve të reja, por më tepër është shtrirje e ideve të mira që tashmë ekzistojnë.

4. Kompetencat e përgjithshme dhe të veçanta

Që nga fillimi i diskutimit të çështjes së kompetencës, u krijua një klasifikim i kompetencave (p.sh. projekti i Tunning) ashtu që të mund të organizohen në kategori të ndryshme. Në këtë projekt propozim ekipi hulumtues i simplifikon këto kategorizime duke bërë një ndarje të thjeshtë në kompetenca të përgjithshme (dmth transversale ose përtej kufijve) dhe kompetenca të veçanta, nisur nga baza se sa më e madhe të jetë thjeshtësia aq më e madhe është mundësia e zbatimit të sistemit.

Dallimi mes kompetencave të përgjithshme dhe atyre të veçanta është i qartë: kategoria e përgjithshme i referohet kompetencave transversal apo të përtej kufirit që aplikohen në fusha të ndryshme të dijes. Me termin të veçanta ekipi hulumtues i referohet aspekteve të veçanta që lidhen vetëm me një fushë të caktuar të dijes.

Si shembull, në Universitetin e Girones kompetencat e përgjithshme janë këto:

- Përdorimi i anglishtes,
- Mbledhja dhe klasifikimi efektiv i informacionit
- Përdorimi i teknologjisë të informatikës dhe të komunikimit
- Puna në ekip
- Komunikimi me gojë dhe me shkrim
- Evaluimi i qëndrueshmërisë së veprimeve dhe propozimeve vetanake të studentit
- Analiza e implikimeve etike të veprimeve profesionale
- Hartimi i propozimeve kreative

Lista në vijim paraqet kompetencat e veçanta:

- Përcaktimi i prioriteteve, qëllimeve dhe objektivave për tretman (psikologji)
- Identifikimi dhe përshkrimi i raportit mes botës natyrale dhe asaj të kultivuar në terene të ndryshme (gjeografi)
- Diskutimi dhe paraqitja e argumenteve ligjore në raport me pjesë të ndryshme të kodit ligjor (ligjësi)
- Hartimi i kurseve për tretman të individëve, familjeve apo grupeve, evaluimi i impaktit të tyre dhe bërja e adaptimeve të nevojshme (ifermieri)

Në këtë formë përfshihet e tërë përmbajtja e një kursi të caktuar në listën e kompetencave të kursit përkatës, në atë këtë mënyrë që lista e kompetencave (të përgjithshme dhe të veçanta) të ndërtojë profilin e të diplomuarit. Kjo gjë përbën atë që mund të quhet Katalogu i Kompetencës që korrespondon me kursin përkatës.

Kështu Katalogu i Kompetencës së një universiteti të caktuar korrespondon me mostrën në vijim:

Katalogu univeristar i kompetencave		
Kursi A	Kompetencat e veçanta për kursin A.	Kompetencat e përgjithshme të universitetit
Kursi B	Kompetencat e veçanta për kursin B.	
...	...	
Kursi N	Kompetencat e veçanta për kursin N.	

5. Si të përpilohet katalogu i kompetencave

Kur një universitet dhe mësimdhënësit e tij nuk janë duke ndërtuar një kornizë të rre për universitetin apo ndonjë kurs të ri atëherë burim i parë i references për listen e kompetencave që një kurs duhet t'i mbulojë duhet të gjendet në detajet e kursit dhe në formën aktuale të kursit përkatës. Për një proces të ridisajnit është e domosdoshme të ndahemi nga premisa bazë se praktikat ekzistuese dhe proceset e mësimnxënies janë valide dhe të dobishme. Kjo sepse duhet të zhvendoset fokusi nga baza në përmbajtje te baza në kompetencë. Këtu edhe konsulenca e jashtme gjithashtu mund të luajë rol me rëndësi. Prandaj, ekipi hulumtues propozon që të përcaktohen kompetencat duke përdorur dy metoda komplementare: reflektimin e brendshëm dhe konsulencën e jashtme.

Reflektimi i brendshëm

Hapi i parë është të arrihet marrëveshja për adoptimin e një definicioni për kompetencën. Siç u tha më sipër në këtë shkrim, ky projekt propozim do të konsiderojë se përvetësimi i kompetencave është një proces kompleks i të mësuarit për të bërë dhe prandaj duhet të formulohet në mënyrë adekuatë: aktivitete reale që janë lehtësisht të observueshme dhe të vlerësueshme, të shoqëruara nga performanca e aktiviteteve përkatëse. Prandaj, është e domosdoshme të rishikohen programet studimore dhe përmbajtjet e tyre për secilën lëndë veç e veç, mbi bazën e kësaj premise, me synim që të identifikohen objektivat e secilit kurs. Për cilën formë të mësimin për të bërë përgatiten studentët nga këto lëndë? Cila formë e të mësuarit për të bërë e konstituon qëllimin për të cilin kursi është ndërtuar? Tabela në vijim është një shembull për një profil të mundshëm pune. P.sh. rreshti i parë mund të përfshijë këto detaje:

Kursi: Arkitekturë		
Lënda	Përmbajtja	Kompetenca e targetuar
Përfaqësimi grafik 1	Pjerrtësitë, kulmet dhe sipërfaqet tokësore	Përfaqësimi grafik i zonave dhe objekteve

...

Duke ndjekur këtë procedure shohim se kompetenca e njejtë synohet të arrihet me material të përmbajtjeve të ndryshme. Një gjë e tillë është fare e natyrshme, meqë kompetencat konsiderohen të jenë aktivitete komplekse që kërkojnë forma dhe përmbajtje të ndryshme në mënyrë që të mund të vihen në praktikë.

Procesi i njejtë i reflektimit të brendshëm e që është edhe më frytdhënës nëse bëhet në bashkëpunim me njerez të tjerë, mund të përmbajë një aspekt të dytë me fokus në pyetjen se cilat kompetenca duhet të zhvillohen në mënyrë eksplicite në kuptim të një vizioni të veçantë.


Konsulenca e jashtme

Disa pjese të këtij manuali paraqesin në mënyrë të hollësishme metodat dhe sistemet e konsulencës që bëhen për këtë çështje, në një kuadër më të gjërë shoqëror. Mjafton të theksojmë faktin se, përpara se të bëhet çfarëdo lloj konsulence, është e domosdoshme që të bëhet e qartë cili definicioni i kompetencave do të zbatohet dhe pastaj i njëjti të përdoret me të gjitha kontaktet shoqërore.

6. Nga lista e kompetencave deri në klasë

Në procesin e planifikimit të mësimnxënies se bazuar në kompetencë rreziku kryesor është që të përcaktohen kompetencat që nuk janë aspak reale. Në këtë rast kompetencat mund të bëhen një re që fluskon përsipër programit studimor pa pasur lidhje të qarta me vet programin. Kur i qasemi detyrës së planifikimit të proceseve të mësimnxënies me bazë në kompetenca objektiva e kryesore duhet të jetë lidhja reale mes kompetencës dhe asaj që ndodh në klasë.

Duhet të gjejmë ndonjë mënyrë për të siguruar se shkalla e parë e procesit të mësimnxënies (dmth planifikimi) dhe shkalla e fundit (dmth vlerësimi) janë të lidhura ashtu si e tregon diagrami në vijim:



Rruga që duhet ndjekur në këtë model të zhvilluar me qëllim të bartjes së kompetencave përkatëse në klasë duhet të jetë si në vijim:

- Merrni parasysh mundësinë e ndarjes së secilës kompetencë në komponente përbërëse apo në nivele të kompleksitetit, ashtu që të mund të arrini përcaktimin sa më të saktë të mundshëm.
- Lidhni secilën kompetencë ose çdo komponentë përbërëse me një lëndët të caktuar ashtu që secila nga lëndët të ketë një rol për zhvillimin e një pjese të kompetencës përkatëse.

Gjatë këtij procesi secilës kompetencë mund t'i caktohen më shumë se një lëndë qoftë mbi bazën e nivele të ndryshme të kompleksitetit apo mbi atë të komponenteve të ndryshme. Një veprim i tillë e siguron koherencën e përgjithshme të kursit kualifikues. Kjo gjë e bën të mundur të sigurohemi që secila kompetencë do të jetë zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme dhe se asnjë nga lëndët të mos jetë e prekur nga autizmi (në kuptimin që të jetë e lidhur vetëm me një kompetencë) apo të jetë e stërngarkuar me material. Ky veprim mund të ndihmohet nga një tabelë e hapur me dy akse:

Kursi: _____

Lëndët në kurs ↓	Kompetenca në kurs →						
	C1	C2	C3	C4	C5		CN
A1	X		X			X	
A2		X	X		X		
A3		X		X			
	X		X		X		X
AN		X		X		X	

Plani i punës

Në kuadër të secilës lëndë të veçantë, planifikoni punën që përfshihet për secilën nga kompetencat e “ngarkuara”, duke iu përgjigjur pyetjeve në vijim:

- Me çfarë aktivitesh të mësimnxënies duhet të merren studentët ashtu që të mund të përvetësojnë këtë kompetencë? Sa kohë do t'ju duhet për këtë gjë?
- Çfarë materiali dhe çfarë përmbajtje duhet të përdoret për këto aktivitete të mësimnxënies?
- Cilat prej këtyre aktiviteteve, që tashme janë të lidhura me kompetencat do të mund të konsideroheshin aktivitete të vlerësimit?

- A ka ndonjë aktivitet tjetër vlerësues që është disajnuar, në menyrë më të hollsishe, për të përcaktuar përvetësimin e kompetencave?
- Cilat kritere të vlerësimit të përdoren?

7. Arritja dhe shprehja e rezultateve të të nxënit

Kur procesi i mësimnxënies të jetë kompletuar përgjatë vijave të treguara më lart, në fund të një periudhe të caktuar jepet kualifikimi (apo nota) e një kursi si rezultat i aktiviteteve të vlerësimit që ndërmerren për secilin lëndë gjatë kësaj periudhe të caktuar. Është e mundshme (dhe e dëshirueshme) që aktivitete të ndryshme të vlerësimit, madje edhe lëndë të ndryshme të lidhen me një kompetencë dhe të sigurojnë vlerësimin e një kompetence të njejtë. Kjo situatë ia mundëson ekipit hulumtues arritjen e rezultateve të të nxënit në raport me secilën lëndë dhe me secilën kompetencë, përmes menaxhimit adekuat të rezultateve. Informata e arritur ka rëndësi sinjifikative të zbatimit në kontekste të ndryshme: si suplement i kualifikimit europian, në kontekst të kornizës së kualifikimeve etj.

Në të njëjtën kohë, sistemi gjithashtu lejon mundësinë që përgjatë periudhave të ndryshme të kursit të bëhet monitorimi i zhvillimit të kompetencave të studentëve, një instrument shumë sinjifikativ që ligjëruesve ua bën të mundur për të rregulluar procesin e mësimnxënies, ndërsa studentëve u mundëson t'i ridrejtojnë energjitë e tyre nëse kjo gjë u kërkohet.

Zhvillimi i kompetencave me detyra jo rutinore: harmonizimi i shkathtësive me nevojat e tregut të punës në dritën e mundësive të teknologjive të reja

Brunella Botte, Giada Marinensi, Carlo Maria Medaglia, CATTID-LaBeL, Sapienza
Universiteti i Romës, Romë

1. Abstrakt

Tregu i punës dhe universitetet nëpër gjithë Europën janë në kërkim të një pike takimi që do të mund të inkurajonte krijimin e një sinergjie të përhershme. Megjithatë, zhvillimet e fundit të konteksteve të punës, që gjithashtu u përcaktuan edhe nga kriza financiare globale, në mënyrë rapide dhe sinjifikative kanë sjellë nevoja të reja për kompanitë, e këto nevoja të reja lidhen me kompetencat e profesionistëve dhe me ekspertizën e punëtorëve.

Prandaj cila është mundësia që universitetet të ballafaqohen me këto kërkesa të reja?

Që të mund të japim një përgjigje për këtë pyetje, duhet që së pari t'i identifikojmë kompetencat kryesore që i nevojiten tregut të punës. Më pastaj, do të bëhet një analizë e projektit European “Në kontakt me tregun e punës” (Labour Market in Touch) me qëllim të përgjigjes në këtë pyetje nga një pikëvështrimi tjetër. Pastaj, do të jetë e mundur të shihet se si mund të përdoret paradigma e mësimnxënies së bazuar në kompetencë ashtu që këto shkathtësi që i duhen tregut të punës të mund t'u barten punëtorëve të ardhshëm në mënyrë adekuate, posaçërisht në dritën e zotërimit të teknologjive të reja.

2. Hyrje

Gjatë këtyre viteve të fundit ngjarjet botërore kanë sjellë ndryshime drastike në të gjitha fushat e ekonomisë botërore. Si pasojë që të gjitha proceset e përfshira në ekonominë botërore kanë pësuar dëmtime drastike. Me qëllim që të mbeten kompetitivë gjatë dhe madje edhe pas kësaj krize të ekonomisë botërore duhet që përsëri të përshpejtohen proceset në mënyrë që të ngritet kompetitiviteti dhe të minimizohen rreziqet që janë në koherencë me krizën financiare.

Kriza financiare ka shkaktuar dridhje masive në ekonominë e Bashkimit European prandaj duhet ndërmarrë hapa që të stabilizohet dhe riformohet ekonomia dhe dinamika e punës së saj.

Nevoja që të trajtohen kërkesat e reja të tregut të punës në njëfarë mënyre i ka detyruar kompanitë që të kërkojnë një ekspertizë më ndryshe si dhe trajnime më të përshtatshme dhe të vazhdueshme për punëtorët.

Me qëllim të përmbushjes së këtij synimi, CEDEFOP që është qendra europiane për zhvillim vokacional dhe trajnim ka bërë një anketim me 2010 që të analizojë shkathtësitë

më të kërkuara dhe më të rëndësishme për punët ekzistuese të tregut të punës (sipas klasifikimit të ISCO) në vendet e Bashkimit Europian. Raporti theksonte se shkathtësitë më të rëndësishme janë ato që mundësojnë menaxhimin e detyrave jo rutinore, me një fjalë ato detyra që nuk menaxhohen me anë të teknologjisë. Me këtë anketim trans-kompetencat sikur janë: gjetja e zgjedhjeve për problemet, menaxhimi i vetvetes dhe shkathtësitë e komunikimit u identifikuan si kompetencat më të rëndësishmet në tregun europian të punës.

Po, cilat janë, më saktë kompetencat që mundësojnë menaxhimin e detyrave jo-rutinore?

Tani për tani nuk ka një klasifikim të këtyre shkathtësive në kontekstin europian edhe pse Europa po shkon në drejtim të gjetjes së përgjigjes në këtë pyetje.

Një shembull i këtij trendi në Bashkimin Europian është projekti: “Në kontakt me tregun e punës: shkathtësitë e reja jo-rutinë nëpërmjet mësimnxënies të bazuar në lojën mobile” që ka nisur me 2010 dhe është sponsorizuar nga Programi për Zhvillim dhe inovacion Leonardo da Vinçi.

3. Projekti: “Në kontakt me tregun e punës”

Qëllimi i projektit “Në kontakt me tregun e punës” është që të përcaktojë një qasje inovative dhe të dobishme për gjeneratat e reja të punëtorëve ashtu që ata të mund të përmirësojnë kompetencat e tyre më të rëndësishme jo rutinë në një mënyrë fleksibile dhe të avancuar në planin teknologjik. Më tutje, projekti synon që kjo qasje të jetë në koherencë me nevojat e reja të tregut të punës.

Burim inspirimi për këtë projekt dhe synimet e tij është strategjia europiane e përmbledhur në dokumentin “Kompetenca të reja për punë të reja” që paraqet një studim të bërë nga Bashkimi Europian. Sipas këtij studimi, partnerët e “Në kontakt me tregun e punës” do të krijojnë një korpus trajnimi për punëtorë të moshës madhore, i cili bazohet në mësimin mobil dhe mbështetet në procesin e sistemit hap pas hapi.

Hapi i parë drejt realizmit të këtij synimi është identifikimi i shkathtësive më domethënëse jo-rutinore në secilin prej vendeve të përfshira. Kjo është bërë përmes një pune hulumtuese të komponuar nga një hulumtim përgatitor sekondar, i pasuar nga një hulumtim tjetër në teren.

Synimi i hulumtimit sekondar ishte të bëhej identifikimi i shkathtësive më të rëndësishme jo-rutinore, përmes mbledhur skenarë të rëndësishëm pune në ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Më pastaj, me qëllim të identifikimit të dhjetë shkathtësive jo-rutinore më të nevojshme në Europë, partnerët kishin identifikuar secilin nga dhjetë persona mes zyrtarëve administrativë dhe menaxherëve të përfshirë në vendimmarrjeje.

Metoda që u përdor ishte intervista gjysmë e strukturuar. Në fazën e parë të hulumtimit në teren, secilit respondent iu kërkoi që të vlerësoje me notë, prej 1 (e parëndësishme) deri në 4 (shumë e rëndësishme), secilën nga shkathtësitë e paraqitura me qëllim të qartësisht të shkallës së rëndësisë për secilën shkathtësi.

Pastaj, secilës nga këto shkathtësi iu bë një nën-ndarje në komponentë bazë (4 apo 6 komponentë për secilën shkathtësi) çdo komponentë duhej të vlerësohej me notë prej 1

deri në 4 sipas rëndësisë që ka. Respondentëve iu kërkua që krahas notës të jepnin edhe një përshkrim të shkurtër për të shpjeguar motivin e tyre për vlerësimin që kishin bërë, në mënyrë që gjithçka të kuptohej sa më mirë.

Në hapin tjetër që të gjitha të dhënat e mbledhura, u ekzaminuan dhe u bashkuan ashtu që të mund të bëhej evaluim i njëjtë për secilën shkathtësi.

Shkathtësitë që morën notat më të larta për rëndësinë që paraqesin ishin këto: iniciativa, inovacioni, mendimi strategjik, gatishmëria për ndryshim, motivimi inspirues, puna në ekip, përmirësimi i vazhdueshëm, vendimmarrja, planifikimi, menaxhimi i konfliktit, komunikimi dhe fleksibiliteti.

Po, si mund të mësohen këto shkathtësi?

Metodologjia e mësimnxënies së bazuar në kompetencë mund të jetë një përgjigje për këtë pyetje. Kjo është një paradigmë e mësimnxënies që mund të ndërtojë ura lidhëse mes botës arsimore, trajnuese dhe tregut të punës.

Me anë të kësaj metodologjie bëhet i mundur përshkrimi i kualifikimeve dhe shkathtësive jo vetëm sipas kualifikimit universitar por gjithashtu edhe sipas kuptimit të kompetencave.

4. Mësimnxënia e bazuar në Kompetencë

Për tregun e punës ka rëndësi të dihen vitet e mësimnxënies teorike por gjithashtu është e rëndësishme, madje edhe më shumë, të dihet se çfarë performance është e mundur të arrihet sipas kësaj dije të ofruar. Shkurtimeisht ky është kuptimi i konceptit të mësimnxënies së bazuar në kompetencë.

Kjo paradigmë ka lindur në SHBA me 1970, lidhet me një lëvizje arsimore që e mbështeste përcaktimin e qëllimeve të mësimnxënies sipas përshkrimit të saktë dhe të matshëm të dijes, shkathtësive dhe sjelljeve që duhet t'i kenë studentët në mbarim të studimit të tyre.

Ndryshe nga sistemet tradicionale të mësimnxënies, që e përdorin kohën si njësi progresive dhe kanë një qasje me mësimdhënësin në qendër, mësimnxënia e bazuar në kompetencë ka njësitë e veta të matjes së përvetësimit të ndonjë shkathtësie të caktuar dhe për më tepër, është me rëndësi thelbësore të përmendim, kjo qasje e vë studentin në qendër.

Në këtë rast është me rëndësi thelbësore të bëhet zgjedhja e saktë e shkathtësive dhe kompetencave që duhet mësuar dhe që teoria rreth këtyre shkathtësive të vihet në praktikë. Gjithashtu është e rëndësishme të gjendet një strukturë adekuate e trajnimit ashtu që teoria e mësuar të mund të zbatohet në praktikë.

Mirëpo, edhe trajnimi i bazuar në kompetencë ka shkëlqimin dhe dritëhijet e veta mu sikur çdo paradigmë tjetër e mësimnxënies.

Mundësia e zbatimit të lehtë e përvetësimit të kompetencave dhe shkathtësive në tregun e punës dhe opimalizimi i kohës së mësimi për shkak të rolit të ri të mësimdhënësve janë dy përparësi të kësaj strategjie të mësimnxënies.

Megjithatë, këto përparësi mund të shndërrohen në mangësi në rast se nuk shqyrtohen me kujdes paraprakisht: për shembull, specifikimi i gabuar i shkathtësive dhe kompetencave që duhet mësuar mund të sjellë rezultate të këqija të trajnimit.

Prandaj, e rëndësishme është që qëllimet e kursit të bëhen të qarta që në fillim ashtu që trajnimi të strukturohet në mënyrë të drejtë dhe të përshtatshme.

Dhe në fund fare duhet ta mbajmë në mend se formimi i kurseve të trajnimit të bazuar në kompetenca është më i shtrenjtë se formimi i kurseve të vjetra klasike të mësimin për shkak të elementeve praktikë.

5. Të promovohet adoptimi i paradigmes së mësimnxënies me bazë në kompetencë: mundësitë e teknologjive të reja

Në paragrafët e mësipërm u identifikuan dhe u përshkruan shkathtësitë jo-rutinore më të kërkuar në tregun evropian të punës, dhe u propozua një paradigmë adekuate e mësimnxënies për përvetësimin mjeshëtor të këtyre shkathtësive. Ajo që ka mbetur pa u trajtuar deri tani është: cilat janë mjetet më të përshtatshme të mësimnxënies për arritjen e këtij qëllimi.

Pra, në fushën e trajnimit mbi bazën e kompetencave elementet praktike janë me rëndësi thelbësore për qëllim të rikrijimit të një mjedisi në të cilin, grupi i targetuar dëshiron t'i përjetojë situatat reale. Mirëpo, duhet pasur parasysh se e gjithë kjo mund të jetë tejte e shtrenjtë duke u nisur nga sasia e burimeve të nevojshme.

Përdorimi i simulimeve paraqet një zgjedhje të mundshme për të kapërcyer situatën. Falë simulimeve bëhet e mundur që të studiohen fenomenet që zakonisht janë tepër larg në kohë ose hapësirë, që janë shumë të rrezikshëm, tepër të mëdhenj ose tepër të vegjël, që kërkojnë kohë shumë të gjatë ose shumë të shkurtë për t'u zhvilluar krahasuar me kohën tonë biologjike, që janë abstrakte apo të papërceptueshëm nga shqisat tona.

Ekzistojnë simulime të llojeve të ndryshme dhe gjithashtu ato mund të kenë synime të ndryshme. Mund të përdoren për të studiuar aktivitete shkencore apo mënyrë e të sjellurit, me anë të dijes matematike mund të vendosen në bazë apo në ndonjë strukturë të thjeshtë të degëzuar.

Simulimet zakonisht përdoren në trajnimet që nuk kanë të bëjnë me teori po me shkathtësi praktike dhe ku paradigma e mësimnxënies është "mësimi në veprim".

Posaçërisht e lidhur me temën e këtij shkrimi për të vënë në praktikë teorinë e mësimnxënies me bazë në kompetencë sugjerohet një mjet që është Loja Serioze, një simulim i llojit të veçantë, që u krijua nga ndërprerja me botën e lojës.

Lojrat serioze mund të përcaktohen si përvoja interaktive që paraqesin pamje dhe ndjenja të një loje të vërtetë por që kanë qëllime të ndryshme siç janë trajnimet, fushatat e vetëdijesimit arsimor, aktivitetet promovuese dhe fushatat shoqërore. Për më tepër, ato mund të rikrijojnë situata reale ku përdorimi i dijes dhe veprimi strategjik ndihmojë për arritjen e qëllimit final.

Përdorimi i Lojërave Serioze në kontekstin e trajnimit të bazuar në kompetencë jo vetëm që qon te përparësia tipike e simulimit të “mësimin në veprim” por duke e përfshirë forcën e videolojërave e bën dobinë edhe më të madhe.

Siç u tha më sipër, shkathtësitë që nevojiten më shumë në tregun evropian të punës janë shkathtësitë e buta. Prandaj ka rëndësishëm që të zgjidhen lloje e përshtatshme të lojërave serioze; sipas klasifikimit që është bërë nga Botte, Matera dhe Sponsiello (2009) lloji i duhur i lojërave serioze për të mësuar shkathtësitë e buta janë TaleSim.

Në TaleSim përdoruesi “jeton” dhe “vepron” përbrenda një ngjarje të vërtetë.

Duke u nisur nga një sfond inicial, përdoruesi duhet të bëjë zgjedhje ashtu që të mund të arrijë qëllimin final. Mirëpo, kjo arritje nuk është qëllimi i vetëm. Përdoruesi i kësaj loje serioze duhet të ketë përfituar nga kjo lojë, në kuptim të zbatimit të shkathtësive të buta, por duhet theksuar se shkalla e përfitimit qëndron te përgjegjësia e përdorimit.

Në këtë rast zona e ndërveprimit paraqet elementet dhe skenarët e ngjarjes në mënyrë tejet përfshirëse falë asaj që Ronsivalle e quan “manipulim i drejtpërdrejtë”.

Kompleksiteti i TaleSim varet nga skenarët e zbatuar. Mund të përdoret një strukturë e thjeshtë degëzimi ose një makinë dinamike me sistem të komplikuar.

6. Përmbledhje

Ky dokument e tregon një mënyrë të mundshme që universitetet mund ta përdorin për të gjetur një pikë të re takimi me tregun e punës. Po ashtu, me anë të analizës së projektit evropian “Në kontakt me tregun e punës” tregon se si kanë ndryshuar kompetencat dhe shkathtësitë e punëtorëve si pasojë e krizës financiare.

Për të harmonizuar nevojat profesionale me ato arsimore e rëndësishme është zgjedhja e paradigmës së duhur të mësimnxënies. Në këtë rast teoria e mësimnxënies me bazë në kompetencë u identifikua si zgjedhja e drejtë.

Studentët mund të arrijnë përvetësimin mjeshtëror të shkathtësive të nevojshme me anë të përvojës praktike: kjo bëhet e mundur falë lojërave serioze, mënyrë kjo e përballueshme dhe efektive për “veprim” në skenarë reale.

Për universitetet do të jetë përvojë e mrekullueshme që të provojnë një mënyrë të re të arsimimit të studentëve: përfshirja e fuqisë së lojërave e bashkuar me teorinë jep themele më të mira dhe më të kompletuara, gjithashtu jep edhe të kuptuar më të mire të dinamikave reale të punës.

Kjo mund të jetë një mënyrë shumë e mirë për të zvogëluar distancën në mes të universiteteve dhe tregut të punës.

Sistemi i kompetencës i bazuar në ECTS

Filip De Bal, KaHoSint-Lieven, Gent

1. Hyrje

Në vitin 2004, u organizuan takimet e para të menaxhimit të kompetencave në KAHO. Menaxhmenti qendror vendosi të zbatojë mësimnxënien e bazuar në kompetencë në të gjitha departamentet. Falë energjisë pozitive të personelit tonë arsimor shumë aktivitete të mësimnxënies tashmë ishin drejtuar kah kompetenca. Megjithatë, akoma mbetet shumë punë për t'u riorganizuar dhe strukturuar.

Në një organigramë të mësimnxënies, pavarësisht se cilës fushë i takon ajo, duhet ndërmarrë hapat e njëjtë si te rrethi i Demig.

2. Planifiko, bëj, kontrollo, vepro

Aktivitetet e mësimnxënies duhet të planifikohen. Ky aktivitet i mësimnxënies duhet të forcojë kompetencat e synuara. Studenti duhet t'i performojë aktivitetet e planifikuara ashtu që të mund t'i përvetësojë kompetencat e synuara. Në hapin tjetër duhet kontrolluar se në çfarë shkalle ka arritur student t'i përvetësojë këto kompetenca. Në hapin e fundit kryhen veprimet e domosdoshme, nëse janë të domosdoshme.

Para së gjithash, gjithçka që një student duhet ta mësojë, përfshi këtu përmbajtjet e temave të caktuar të profesioneve përkatëse duhet të përkthehet në kompetenca. Sipas natyrës që kanë kompetencat ndahen nëpër grupe kompetencash.

Grupit të parë i takojnë kompetencat e përgjithshme, siç janë “veprimi metodik dhe sistematik në funksion të prodhimit apo zhvillimit të dijes kreative”, “kompetenca e komunikimit; si i komunikohet informacioni, idetë, problemeve dhe solucionet një specialistit e si një tjetri që nuk është specialist i fushës”.

Lista e dytë është lista e kompetencave shkencore të përgjithshme të orientuara nga profesioni. Këto janë kompetenca të përgjithshme, që bazohen në nivelin e kualifikimit, qoftë kualifikimit profesional apo kualifikimit akademik.

Në sistemi flaman të arsimit kompetencat e grupit të parë dhe të dytë radhiten dhe saktësohen nga Ministria e Arsimit.

Tabela 1 paraqet një pamje të listës së kompetencave, të saktësuar nga Ministria e Arsimit. Kodet i referohen kualifikimeve (PB, Professional Bachelor; AB, Academic Bachelor; M, Master).

- PB – 01. Kapacitetet intelektuale dhe të njohjes
- PB – 02 Përvetësimi dhe procesimi i informacionit
- PB – 03 Mendimi kritik
- PB – 04 Veprimi metodik dhe sistematik në funksion të prodhimit/zhvillimit kreativ të dijes.
- PB – 05 Lidërshipi
- PB – 06 kompetencat komunikative për t'ua komunikuar informacionin, idetë, problemet dhe zgjidhjet qoftë një specialisti apo një jospecialisti.
- PB – 07 Mësimi tërë jetësor
- AB – 01 Posedimi i aftësive të duhura për njohje dhe arsyetim
- AB – 02 Aftësia për të përvetësuar dhe për të operuar me informacion
- AB – 03 Aftësia për të menduarit kritik
- AB – 04 Aftësia për të qenë kreativ
- AB – 05 Aftësia për të zbatuar detyra të thjeshta të menaxhimit
- AB – 06 Aftësia për të komunikuar informacion, ide, probleme dhe zgjidhje qoftë me një specialist apo me një laik
- AB – 07 Paraqitje e provave për angazhim në mësimin tërë jetësor
- M – 01 Aftësia për mendim dhe operim shkencor
- M – 02 Aftësia për të trajtuar probleme komplekse
- M – 03 Aftësia për të menduar dhe për të punuar në mënyrë të pavarur, aftësia për ta shndërruar këtë mendim në një zhvillim të zgjidhjeve adekuante
- M – 04 Aftësia për t'ua komunikuar rezultatet e hulumtimeve personale dhe zgjidhjet e problemeve si kolegëve ashtu edhe personave laikë
- M – 05 Aftësia për të nxjerrë një gjykim në një kontekst të sigurisë
- PB – 08 Aftësia për punë ekipore
- PB – 09 Aftësia për të zgjidhur probleme: kompetenca për përcaktim individual të problemeve, analizimi i problemeve komplekse dhe zhvillimi i zgjidhjeve të dobishme
- PB – 10 Përgjegjshmëria ndaj shoqërisë dhe ndaj fushës profesionale
- AB – 08 Aftësia për menim kërkimor shkencor
- AB – 09 Njohja e metodave dhe teknikave të hulumtimit dhe aftësia për t'i përdorur ato në mënyrë adekuante
- AB – 10 Aftësia për të nxjerrë të dhëna relevante me qëllim të vlerësimit të çështjeve të ndryshme shoqërore, shkencore apo etike
- AB – 11 Posedimi i mundësisë për të nxjerrë një vlerësim të pasigurisë, ambiguitetit dhe kufizimit të dijes
- M – 08 Aftësia për të zbatuar paradigmat në fushën shkencore dhe për të identifikuar kufizimet e paradigmave
- M – 09 Paraqitja e provave për forcën e origjinalitetit dhe kreativitetit në lidhje me ekspansionin e vazhduar të dijes dhe njohurive
- M – 10 Aftësia për të punuar së bashku në një ambient multidisiplinar
- AB – 12 Aftësia për të iniciuar hulumtime mbi bazën e problematizimit
- AB – 16 Aftësia për të punuar në ekip
- M – 07 Aftësia për të përdorur metodat dhe teknikat gjatë hulumtimit
- M – 18 Aftësia për të punuar drejt zgjidhjeve në kuptimin e përcaktimit individual dhe të analizimit të situatave komplekse problematike gjatë praktikës profesionale dhe aftësia për të zhvilluar dhe zbatuar strategjitë e rëndësishme për zgjidhjet
- M – 19 Aftësia për të qenë i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë shoqërore në kontekst të praktikës profesionale

Lista e tretë dhe e katërt kanë të bëjnë me kompetencat që lidhen në mënyrë specifike me profesionet e caktuara ose me kompetenca shkencore. Kompetencat profesionale u caktohen kualifikimeve profesionale ndërsa kompetencat shkencore lidhen me kualifikimet akademike. Këto kompetenca përcaktohen nga departamentet mbi bazën e shqyrtimeve të punës në teren.

Te kualifikimet në inxhinieri, lista e tretë dhe e katërt e kompetencave është shumë gjithpërfshirëse. Si shembull është dhënë llogaritja e fortësisë së një ure prej çeliku. Njeriu di apo nuk di të dizajnojë një ure dhe të llogarisëfor fortësinë e saj. Aktivitetet e mësimnxënies mund të planifikohen me lehtësi. Ushtrimet mund të bazohen në studimet e rastit. Te shembujt e tillë mësimi i bazuar në projekt do të jetë metoda me e zakonshme. Këtu profesorit nuk i intereson koha që studenti e shpenzon për këtë temë. Studentit i duhet ta zgjedhë këtë problem vet dhe poashtu ai vetë duhet të planifikojë kohën e tij. Në fund rezultati është matematik. E kjo e bën vlerësimin shumë të lehtë. Nëse studenti është duke dështuar, kjo gjë mund të ndryshohet fare lehtë. Ai duhet që të mësojë më shumë dhe më gjatë, të bëjë më shumë ushtrim e kështu me radhë. Kompetencat e përgjithshme janë shumë me të komplikuar për kualifikimin inxhinierik. Shpeshherë ato tashmë ndodhen aty falë mësimnxënies me bazë në projekte. Vlerësimi shpeshherë ngushtohet deri në vlerësim nga shokët ose nga gjykimi tradicional subjektiv.



Pas disa mbledhjesh, motivimi për të zbatuar kompetencat e përgjithshme, në një departament mekanik u zbeh fare. Vendimi i përgjithshëm ishte se inxhinierët nuk janë fare të kualifikuar për këtë gjë. Inxhinierët kanë nevojë për një sistem që mund të matet me matematikë.

Në momentin kritik sistemet e kompetencës u zbatuan gjithashtu edhe në industri të ndryshme. Për disa industri të caktuara, shtytja kryesore për ta bërë këtë, është puro financiare. Vlerësimi i bazuar në kompetencë do të thotë përcaktimi i statusit të një të punësuarit. Nga ana tjetër statusi i një të punësuarit e përcakton pagën që e merr ai.

Falë bashkëpunimit të ngushtë me industrinë KAHO arriti të ketë qasje në sistemet e tyre. Në KAHO departamenti i mekanikës zgjodhi një sistem shumë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë që u zhvillua nga departamenti i burimeve humane të një kompanie të madhe. Grupi që u targetua me këtë sistem ishte grupi i prodhimit teknik.

Sistemi përbëhet nga disa faqe të kompetencës. Secila faqe e paraqet një kompetencë. Sipas përshkrimit të indikatorëve të kompetencës kushdo qoftë mund të gjej nivelin e vet të përvetësimit të kompetencës. Njeriu nuk mund të dijë se çfarë është apo si është tjetri. Njeriu mund të dijë si mendon mjedisi për atë person dhe kjo gjë mund të matet duke përdorur indikatorët e kompetencës.

Si shembull mund të marrim kompetencën e faqes PB 06, e cila ka të bëjë me kompetencën në vijim “të ketë aftësinë për t’i komunikuar informacion, ide, problem dhe zgjedhje një specialist e poashtu edhe dikuj që nuk është i profesionit”.

	Disanji mekanik dhe teknologjia e prodhimit	
	Dosja e kompetencave PB 06 përmban aftësinë për t'ua komunikuar informacionin, idetë, problemet apo zgjidhjet si specialistëve ashtu edhe laikëve	

E shpreh vetveten në mënyrë të qartë, të plotë dhe të kuptueshme dhe kujdeset që mesazhi të arrijë ashtu si është më së miri, deri të audiencia së cilës i drejtohet.

Konteksti	Komunikimi është një kompetencë e avansuar e interakcionit që është e rëndësishme për të gjitha situatat profesionale ku punohet së bashku dhe ku krijohen kontaktet.
-----------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Indikatorët e sjelljes

Mungesa/pjesërisht	<ul style="list-style-type: none"> - Nuk arrin të formulojë idetë e veta në mënyrë të qartë apo të kuptueshme me lehtësi. - Harron disa hapa në rrjedhën e diskutimit, është konfuz. - Nuk e merre parasysh publikun e targetuar
Themelore (D)	<ul style="list-style-type: none"> - Njeh disa nocione të mjeteve dhe teknikave të komunikimit. - I formulon idetë e veta në mënyrë mjaft të qartë pa u përqendruar te publiku i targetuar.
Mirë (C)	<ul style="list-style-type: none"> - I zotëron mjetet dhe teknikat e komunikimit. - Zakonisht ia del që të shprehë idetë e veta në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe merr parasysh publikun e targetuar. - Interesohet për të kuptuar nese mesazhi është kuptuar si duhet.
I avancuar (B)	<ul style="list-style-type: none"> - Sjell mjete dhe teknika të reja për të përmirësuar komunikimin. - Ia del që të shprehë idetë e veta në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, edhe nese ato janë të komplikuar. - I adapton shprehjet e veta në mënyrë mjaft fleksibile në funksion të bashkëbiseduesit, iu përgjigjet në mënyrë të përshtatshme pyetjeve të një grupi (të madh) partnerësh.
Shkëlqyeshëm (A)	<ul style="list-style-type: none"> - Posedon standarde të larta për të gjitha format e komunikimit. - Gjithnjë ia del të formulojë idetë e veta në mënyrë të qartë dhe të kuptueshëm madje edhe atëherë kur ato janë shumë të komplikuar. - Bën pyetje që të marrë vesh nese idetë e tij/saj janë kuptuar ashtu si duhet. - Iu ndihmon të tjerëve dhe i inkurajon ata që të kenë diskutime të qarta.

Indikatorët e rezultateve

Studentët që posedojnë këto aftësi do të:	Studentët që nuk posedojnë këtë kompetencë do të:
Mund të kuptojnë mesazhe të caktuara në mënyrë të qartë.	Shprehin idetë që u bien ndërmend në mënyrë të pastrukturuar.
Bëjnë një prezantim apo shkruajnë një dokument në mënyrë të strukturuar.	Në shprehjet e tyre shfaqin padurimin.
E bëjnë veten të kuptueshëm për nivelin e lexuesve të audiencës së vet.	Flasin më shumë se sa shkruajnë.
I parashikojnë pyetjet e lexuesve.	Japin informacionin e duhur, as më shumë e as më pak se sa nevojitet.

Kjo strukturë e thjeshtë jep kritere të qarta. Këto kritere, indikatorët e kompetencës, përdoren nga personeli për të vlerësuar studentët. Atëherë lista e plotë e kompetencës shtrihet nëpër gjithë kurrikulën. Secila kompetencë vlerësohet në disa kushte, nga disa domene dhe nga mbikqyrës të ndryshëm. Atëherë kompetencat listohen në faqet e ECTS-ëve.

Shembull I faqes ECTS

Bachelor për dizajn mekanik dhe teknologji-prodhimi: Bachelor 3 Dizajn Mekanik dhe Teknologji Prodhimi 2010-2011

Automatikë

1. Informatë e përgjithshme

- Kodi: 3004220
- Numri i kredive ECTS: 4
- Mundësi për kontratë provimi: Po
- Gjuha e mësimdhënies: holandisht
- Koordinator i lëndës: Mercx Dirk
- E pranueshme

2. Lloji i njësisë

- Specializim

3. Aktivitetet e kursit

- Hidraulikë
- Automatikë lab. 2
- Teknikë kontrolli.

4. Përmbajtja

- Hidraulikë: zhvillimi dhe funksionimi i pompës hidraulike, motorit, vulvës, kontrolli i presionit, kontrolli i valvulës së rrjedhës
- Automatikë lab: Programimi i PC për zbatim makinash, robotikë, rregullat praktike të PID
- Teknikat e kontrollit

5. Rezultatet e të nxënimit

A. Kompetencat e përgjithshme

- PB – 01. Kapacitetet intelektuale dhe të njohjes
- PB – 02 Përvetësimi dhe procesimi i informacionit
- PB – 04 Veprimi metodik dhe sistematik në funksion të prodhimit/zhvillimit kreativ të dijes.

Shpjegim

Automatikë laboratorike:
Ushtrime për zgjidhjen e problemeve komplekse përmes programimit PLC duke përdorur dijen nga automatika 1 – 4
Integrimi i asaj pjese të automatikës në projektet industriale

B. Kompetencat e përgjithshme shkencore me orientim profesional

PB – 09 Aftësia për të zgjidhur probleme: kompetenca për përcaktim individual të problemeve, analizimi i problemeve komplekse dhe zhvillimi i zgjedhjeve të dobishme

Shpjegim

Përdorimi i metodave të njohura të zgjidhjes së problemeve (grafcet, ujëvarë, diagram kohor) për të arritur zgjidhjen e duhur apo problemin e automatikës.

C. Kompetencat specifike të profesionit

- Aftësia për të përshkruar mënyrën e punës dhe karakteristikat e pjesëve elektronike.
 - Aftësia për të përshkruar mënyrën e punës të qarkut të thjeshtë të ndërtuar te këto komponente.
 - Aftësia për të përshkruar një pajisje elektrike shtëpiake.
 - Aftësia për të përshkruar mënyrën e punës dhe karakteristikat e llojeve të ndryshme të sigurisë për pajisjet shtëpiake.
 - Aftësia për të disajnuar, për të shkruar dhe për të testuar një program të drejtë PLC për probleme realiste automatike.
 - Aftësia për të shpjeguar mënyrën e punës dhe karakteristikat e njësisë kontrolluese.
 - Aftësia për të shpjeguar karakteristikat e kontrolluesit të PID.
 - Familiarizimi me teknologjinë e kontrollit.
 - Aftësia për të përcaktuar parametrat e kontrollit PID duke përdorur njësi të ndryshme rregullash. (Ziegler- Nichols, Trial and error,)
 - Aftësia për të shpjeguar mënyrën e punës të llojeve të ndryshëm të sensorëve (shtypjes, rrjedhës, nivelit)
 - Aftësia për të përshkruar dhe për të disajnuar një qark hidraulik.
 - Aftësia për të përshkruar komponente të ndryshme të hidraulike, të mënyrës së punës, karakteristikat dhe simbolet .
- Përmbajtjet:

D. Kompetencat shkencore

Bachelor për dizajn mekanik dhe teknologji-prodhimi: Bachelor 3 Dizajn Mekanik dhe Teknologji Prodhimi 2010-2011

6. Prerekuizitat

A. Si parakusht janë kërkuar këto kurse

- Dizajni mekanik dhe teknologjia e prodhimit // automatizimi 1
- Dizajni mekanik dhe teknologjia e prodhimit // automatizimi 2
- Dizajni mekanik dhe teknologjia e prodhimit // automatizimi 3

B. Kompetencat e kërkuara

- Studenti tregon sukses në automatikë 3
- Studenti ka njohuri për të analizuar qarkun DC dhe AC
 - Studenti ka njohuri për programimin PLC
 - Studenti ka njohuri për komponentët pneumatikë.

7. Mjetet arsimore

A. Lloji

- Kurse
- Mjete audiovizuale
- Platforma të mësimin online

B. Mjetet të obligueshme arsimore

Kurset: 'Hidraulika' laboautomatike – Delta Press
Hidraulika me prezantime ne powerpoint

C. Mjetet e rekomanduara arsimore

Libri: Hydraulische installaties – Delta Press

8. Metodatat e mësimdhënies

A. Llojet

- HC
- Praktika
- Puna në grupe
- Studimi individual

B. Përshkrimi


- dija dhe aftësitë testohen me anë të vlerësimit
- Gjatë orëve në laborator testohet aftësia e studentit për të përdorur njohuritë e tij (vlerësimi i përgjithshëm, vlerësimi i performancës)
- Studenti duhet të bëjë një raport me shkrim për të treguar përvojat e veta, gjërat që I ka mësuar dhe problemet që i kanë mbetur (portofolio)
- Vlerësimi: hidraulika 2 kredi
- Laboratori: vlerësim i përhershëm 1 kredi
- Shansi i dytë: varet nga kompetencat që akoma nuk janë përfutur, mund të përsëriten një apo më shumë orë laborator
- Shansi i dytë gjithmonë jepet në periudhën e tretë

10. Përkrahja për mësimdhënie

Studentët kanë mundësi të kontaktojnë mësimdhënësin për të marrë shpjegime shtesë, për më tepër ushtrime apo për formë të tjera përkrahje. Kjo mund të bëhet përmes komunikimit elektronik apo kontakteve të drejtpërdrejta.
Në Toledo ekziston një forum ku studentët mund të postojnë pyetjet që ia drejtojnë njeri tjetrit apo mësimdhënësit.

Stafi mban mbledhje në intervale të rregullta ku diskutohen kompetencat dhe sjelljet e studentëve. Përvoja ka treguar se ky sistem është shumë i besueshëm dhe mund të përsëritet. Ndodhë shumë rrallë që një mbikqyrës të ketë vlerësim të ndryshëm me atë të një kolegu tjetër të tij. Edhe nëse ka ndryshime ato vërtetë janë fare të vogla.

Me 2009-2010 ky sistem u vlerësua nga një komision i jashtëm. Ata organizuan një anketë në teren, në industri dhe me ish studentë.



(plot versie: 06/09/2010-15:37) www.ikdoemechanica.be

KAHO-MOPT arriti një rezultat të shkëlqyeshëm dhe një të mirë. Çështje me rëndësi ishte sistemi ECTS i bazuar në kompetencë, i cili ishte i thjeshtë dhe i lehtë për t'u përdorur, për shkak të besueshmërisë dhe mundësisë për t'u përsëritur.

Praktika e mirë e zhvillimit të kurikulës në Universitetin e Prishtinës (UP), Kosovë

Studimi i rastit: Zhvillimi i një masteri të administrimit të biznesit (MAB) në menaxhmentin e shëndetësisë, Fakulteti i mjeksisë

But Dedaj, Milote Sadiku - Musliu, Mjellma Carabegu, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

1. Hyrje

Kyshkrim përshkruan zhvillimin e masterit të administrimit të biznesit (MAB) në menaxhmentin e shëndetësisë, në Fakultetin e Mjeksisë në Universitetin e Prishtinës duke dhënë një pamje të përgjithshme të: përcaktimit të qëllimit të programit të studimit; përcaktimit të objektivave të mësimnxënies së programit; strukturës së programit; krahasueshmërinë dhe ndërkombtarizimin; bashkëpunimin me partnerët në tregun e punës; paanëshmërinë gjinore; akreditimin dhe modalitetet e tjera të parafillimit të programit. Në fund të shkrimit janë nxjerrë disa përfundime dhe janë dhënë disa rekomandime që kanë kontribuar për nismën e suksesshme të mësimdhënies me bazë në kompetencë në UP.

2. Paraqitja e sfondit

Në vitin akademik 2001/2002 UP vullnetarisht mori pjesë në procesin e Bolonjës, dhe gjithashtu vullnetarisht bëri një reformë të madhe të institucionit dhe kurrikulës. Organizimi i programeve të studimit është i bazuar në sistemin e 3 cikleve: Bachelor, Master dhe Doktoratë.

Si përpjekje për t'iu përgjigjur nevojave të sektorit të shëndetësisë në Kosovë, Universiteti i Prishtinës, respektivisht Fakulteti i Mjeksisë vendosi të ndërtojë një MAB për menaxhmentin e shëndetësisë. Tradicionalisht, Universiteti i Prishtinës gjatë ekzistencës 40 vjeçare ka dhënë vetëm diploma shkencore. Ky program paraqet të parin program profesional që bazohet në nevojat e sektorit kosovar të shëndetësisë. Për më tepër, nisur nga fakti se programi ka orientim profesional gjithë mësimdhënia dhe zhvillimi i programit u bë në gjuhën angleze nga profesorë kosovarë dhe ligjërues vizitorë nga institucionet partnere të BE. Në këtë kuptim programi nuk paraqet vetëm kualifikimin e parë profesional që jep UP por gjithashtu e paraqet edhe programin e parë ku mësimdhënia u zhvillua në gjuhën angleze nga profesorët vendorë.

3. Proceset e zhvillimit të programit të mësimit

Rëndësia e tregut të punës për zhvillimin e programit të studimit.

Situata e tanishme e sistemit shëndetësisë të Kosovës është mjaft e vështirë ngaqë sistemi shëndetësor vazhdimisht përballlet me pengesa të vazhdueshme të shkaktuara nga mungesa e menaxherëve të shkolluar dhe të aftë. Sistemet informative në shëndetësi janë në fazë shumë të hershme të zhvillimit. Përveç kësaj, gazeta vjetore e statistikave mjeksore e vitit 2006 paraqet statistika lidhur me situatën e përgjithshme të shëndetësisë dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve në sistemin shëndetësor të Kosovës. Kështu, dokumentet zyrtare të qeverisë (strategjia e shëndetësisë 2005-2015) dhe studimet e organizatave të rëndësishme ndërkombëtare si Banka Botërore: Vlerësimi i varfërisë në Kosovë (Kosovo Poverty assessment), 2007, vëllimi I dhe II; dhe Studimi i reformës financiare në shëndetësinë kosovare, (Kosovo Health Financing Reform Study), 2008, tregojnë se ka nevojë të madhe për ekspertizë në menaxhimin shëndetësor përmes së cilës bëhet e mundur që e gjithë fusha e biznesit të mund të ballafaqohet me sfidat që dalin nga situata e re ekonomike dhe politike.

Krahas raporteve që u përmendën më lart, u bë edhe një hulumtim i tregut të punës me aktorët kryesorë të sektorit të shëndetësisë kosovare si: Qendra klinike universitare Prishtinë, spitalet regjionale, qendrat kryesore për mjeksi familjare, Ministria e shëndetësisë së Kosovës, spitalet dhe klinikat private dhe Klinika Dentare Universitare e Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte matja e nevojat për një profil të tillë të cilin duhet ta ketë eksperti i sektorit shëndetësor. Rezultati i anketës verifikoi përfundimet e raporteve të ndryshme zyrtare. Kështu u furcua fakti se ka nevojë të shtuar të këtyre institucioneve për kandidatët të profilit të tillë.

Përcaktimi i qëllimit të programit të studimit

Duke u mbështetur në rezultatet e raportit, qëllimi i përgjithshëm i programit të studimit është hartuar si në vijim:

“Programi MAB në menaxhmentin e shëndetësisë përgatit studentë për sfidat bashkohore me të cilat ballafaqohen sistemi i mirëqenies sociale dhe sistemi kombëtar i shëndetësisë, duke e ndihmuar kështu zhvillimin e mëtejshëm të kujdesit shëndetësor në nivel lokal dhe kombëtar. Për më tepër, i pajisë studentët me të gjitha shkathtësitë administrative dhe menaxhuese që nevojiten për të bërë karrierë në organizata të ndryshme private dhe publike, OJQ, kompani dhe në institucione të kujdesit shëndetësor, duke pasur parasysh edhe teorinë organizative dhe ekonominë klasike. Veç kësaj, ua mëson studentëve edhe aftësitë analitike të nevojshme për të zgjidhur probleme të kompleksitetit të lartë shoqëror gjithashtu i rrit kompetencat e studentëve për komunikim efektiv dhe për punë ekipore drejt realizimit të qëllimeve të caktuara.

Programi, gjithashtu, ka për qëllim të përgadisë të diplomuar jo vetëm për tregun lokal, por edhe për atë ndërkombëtar.

Përcaktimi i rezultateve të të nxëniet të programit të studimit

Pas hartimit të objektivave të programit të studimit, objektivat e mësimnxënies të nivelit të këtij programi janë zhvilluar ashtu që të përmbajnë rezultate të përgjithshme dhe të veçanta. Pas përfundimit të programit MAB në menaxhment të shëndetësisë, studentët do të:

- jenë të aftë të demonstrojnë të kuptuarit kritik të koncepteve kyçe dhe teorive të lidhura me menaxhmentin e shëndetsisë
- zhvillojnë shkathtësi praktike në udhëheqje, menaxhim, ndërtimi të kapaciteteve, që lidhen me situatat e krijuara dhe me kapacitetet e limituara
- kenë dije praktike për mjediset dhe për të monitoruar e kontrolluar problemet e veçanta me të cilat ballafaqohen institutet mjeksore.
- jenë të aftë për të zhvilluar zgjidhjet e tyre novatore dhe kreative në pajtim me nevojat e krijuara.
- bëhen menaxherë edhe në situata normale edhe në ato të jashtëzakonshme.

Struktura e programit të studimit

Universiteti i Prishtinës përdor Sistemin European të Transferit të Kredive (ECTS) për të strukturuar programet e tij në harmoni me procesin e Bolonjës. Meqë programi ka orientim profesional, ai përbëhet nga vetëm 90 ECTS dhe zgjat dy vite (4 semestra).

Krahasueshmëria dhe ndërkombtarizimi

Modulet janë krijuara në bashkpunim me institucionet e binjakëzuara të arsimit të lartë nga një shtet i BE, si dhe me partnerët nga tregut Kosovar i punës (këta njëherësh ishin pjesë e hulumtimit). Modulet kanë orientim praktikë, meqë janë krijuar mbi bazën e modelit që i përgjigjet kërkesave dhe sfidave të sistemit Kosovar të shëndetësisë dhe mbi shembujt e kurikulës së partnerit binjak të arsimit nga BE. Një nga kriteret kryesore që UP e ka inicuar është kërkesa që secili program i ri duhet ndërtuar ashtu që do të ketë rreth 85% ngjajshmëri me një program të një universitet European. Pastaj zhvillimi i një programi që ka ngjajshmëri me një program në një universitet të BE lë mundësi për bashkëpunim më të lehtë me universitetet nga BE dhe e rrit krahasueshmërinë e programit. Kështu, bashkëpunimi i lehtë i shton shanset e ndërkombëtarizimit të një fakulteti në kuptim të lëvizshmërisë së personelit dhe të studentëve dhe e gjithë kjo kontribuon në drejtim të ndërkombëtarizimit të vet UP-së.

Instituti binjak i arsimit të lartë të BE e ndihmoi zhvillimin e programit duke kontribuar me ekspertizë gjithashtu e mbështeti edhe procesin e mësimdhënies duke dërguar ligjërues vizitorë në UP.

Bashkëpunimi me partnerët e tregut të punës

Një bashkëpunim i ngushtë u zhvillua me aktorët kryesorë të sektorit të shëndetsisë në forma të ndryshme, bashkëpunimi me ligjëruesit vizitorë për mësimdhënie në lëndë apo kurse të caktuara në kuadër të një moduli, krijimit të mundësive për praktikë profesionale, ndihmës konkrete për zgjedhjen dhe formulimin e tezave etj.

Paanësia gjinore

Paanësia gjinore është zbatuar në aspekte të ndryshme të kuadrit të projektit:

- Balansimi i pjesmarrjes gjinore në procesin e seleksionimit të studentëve
- Integrimi i aspekteve gjinore në module dhe lëndë p.sh. përfshirja e kapitujve që lidhen me çështje të caktuara gjinore
- Përdorimi i gjuhës që promovon balancin gjinor si gjatë ligjëratave ashtu edhe në materiale mësimore

Akreditimi dhe modalitete tjera të parafillimit të programit

Çdo program i ri studimit në Universitetin e Prishtinës, qoftë i ri fare apo i modifikuar duhet të kalojë përmes miratimit të Senatit. Pasi të jetë miratuar, programi si i tillë duhet të paraqitet për akreditim në Agjensionin Kosovar të Akreditim. Pas kësaj, agjensioni, përmes procedurave të veta merr vendim që ta akreditojë ose jo programin e ri të studimit. Nëse programi nuk akreditohet mund ka mundësi që të pranojë studentë të rinj.

Programi MAB në Shëndetësi është akredituar me sukses nga Agjensioni Kosovar për Akreditim. Si rezultat, 36 studentë janë regjistruar në programin e studimit për vitin akademik 2009/2010.

Duke pasë parasysh të gjithë hapat e përmendur më sipër, ky program si i tillë përfaqëson një model të mirë të zhvillimit të kurikulës jo vetëm për Universitetin e Prishtinës por edhe për gjithë sistemin e arsimit të lartë të Kosovës.

4. Përfundim

Universiteti i Prishtinës duke qenë i përbërë nga 17 fakultete ballafaqohet me shumë probleme dhe sfida. Prandaj, është shumë e vështirë që secili nga programet e tij të ndjek të gjithë hapat ashtu si janë paraqitur gjatë zhvillimit të MAB në menaxhmentin e shëndetësisë (dhe në disa programe tjera të nivelit Master)

Pika e takimit e të gjitha dokumenteve ekzistuese të arsimit të lartë në nivel evropian është apeli që të merret parasysh “aspekti i punësueshmërisë së të diplomuarve” dmth që në të ardhmen programet e studimit që kanë shkallën më të lartë të punësimit do të mbijetojnë brenda institucioneve të arsimit të lartë. Duke marrë parasysh që universitetet publike tradicionalisht janë të njohura të kenë orientim më të madh teorik, institucionet e arsimit të lartë kudo nëpër Europë e jo vetëm në Kosovë para vetes e kanë sfidën e madhe të transformimit gjigand të programeve të studimit në mënyrë që të mund të garantojnë punësim të shpejt të të diplomuarve të tyre.

Sipas procesit të Bolonjës është paraparë që hapësira e arsimit të lartë evropian të:

- Ndihmojë lëvizshmërinë e studentëve, të të diplomuarve dhe të stafit të arsimit të lartë,
- Përgatisë studentët për karrierat e tyre të ardhshme dhe për të bërë një jetë si qytetarë aktivë në shoqëri demokratike dhe të mbështesë zhvillimin e tyre personal

- Ofrojë qasje të gjerë në arsimin e lartë cilësor, të bazuar në principet demokratike dhe lirinë akademike

UP duke e zbatuar vullnetarisht procesin e Bolonjës duhet që edhe më tej të investojë mund të madh për të arritur realizimin e këtyrë 3 objektivave, meqë synon të bëhet pjesë e hapësirës së arsimit të lartë europian sa më parë që të jetë e mundur.

5. Rekomandimet

Edhe pse UP ka sfida të mëdha para vetes për të bërë zhvillimin e mësimin të bazuar në kompetenca, disa nga rekomandime e domosdoshme përmbajnë:

- Zhvillimi i programeve të studimit (sidomos programet e reja) të bazuar në kompetencat të veçanta dhe të përgjithshme
- Bashkëpunim i ngushtë me tregun kosovar të punës për të kuptuar nevojat e tij nëpërmjet mjeteve dhe metodave të ndryshme
- Hartim të kurikulës duke përfshi informacionin e partnerëve nga tregu i punës për fusha specifike
- Përkrahje të vazhdueshme për studentë në zhvillimin e tyre profesional përmes këshillimit për karrierë dhe shërbime të tjera të ndryshme.



Tempus



CUP – KOMPETENCA NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Kordinatori i projektit




UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES

Partneret e projektit



Universitat d'Alacant Fundació General
Universidad de Alicante Fundación General



right to education



SAPIENZA
UNIVERSITÀ DI ROMA



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

